

MIMOZA PRIKU LEZE CACAJ

UDHËTOJMË ME GJUHËN

GJUHA SHQIPE 3

**për klasën e tretë të shkollës fillore
Libri i mësuesit/es**

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2025

Dr. MIMOZA PRIKU Mr. LEZE CACAJ
GJUHA SHQIPE 3 - UDHËTOJMË ME GJUHËN
për klasën e tretë të shkollës fillore

Libri i Mësuesit

ALBANSKI JEZIK 3 - PUTUJEMO S JEZIKOM

Za treći razred osnovne škole

Priručnik

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Për botuesin: Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor: Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës: Llazo Leković

Redaktor: Dimitrov Popović

Recensues: Dr. Artan Haxhi

Mr. Anton Gojçaj

Teuta Gjokaj

Fran Vulaj

Mr. Ardita Kovaçević

Lektor: Albana Lulanaj

Dizajni dhe faqosja: Momçillo Qorsoviq

Ilustrimet: Mersiha Resulbegović

Redaktore teknike: Dajana Vukçević

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2570-0

COBISS.CG-ID 36397828

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 08/2-119/25-7446-9,
datë 16.07.2025 e ka miratuar këtë Komplet të tekstit mësimor për përdorim në
shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2025

Përmbajtja e lëndës

Hyrje	4
Kapitulli I Komunikojmë dhe shkruajmë	6
Mësimi 1. Komunikojmë dhe bashkëbisedojmë	7
Mësimi 2. Rregullat e bisedës. Vjeshta në kopshtin tim	9
Mësimi 3. Bisedojmë në telefon	12
Mësimi 4. Fjala, fjalia dhe teksti. Krijojmë tekste sipas figurave	15
Mësimi 5. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit	18
Mësimi 6. Letra dhe kartolina	21
Mësimi 7. Urojmë dhe mësojmë të lëmë shënime	23
Mësimi 8. Tregojmë dhe shkruajmë sipas figurave	26
Mësimi 9. Flasim gjuhë të ndryshme	28
Kapitulli II Mësojmë për fjalët dhe fjalitë	31
Mësimi 10. Pjesët kryesore të fjalisë	32
Mësimi 11. Pjesët plotësuese të fjalisë	35
Mësimi 12. Fjalia e thjeshtë dhe fjalia e zgjeruar	38
Mësimi 13. Fjalia dëftore, fjalia pyetëse dhe fjalia thirrmore	41
Mësimi 14. Mësojmë shenja të tjera të pikësimit	45
Mësimi 15. Mësojmë fjalët që tregojnë njerëz, kafshë, sende ose vende	48
Mësimi 16. Emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm	51
Mësimi 17. Gjinia e emrit	55
Mësimi 18. Numri i emrit	58
Mësimi 19. Fjalët që tregojnë cilësi	61
Mësimi 20. Mbiemrat e nyjshëm dhe mbiemrat e panyjshëm	64
Mësimi 21. Gjinia e mbiemrave	67
Mësimi 22. Numri i mbiemrave	70
Mësimi 23. Unë jam Andi	73
Mësimi 24. Folja	77
Mësimi 25. Sot - dje – nesër	80
Mësimi 26. Foljet ndryshojnë	83
Kapitulli III Lexojmë dhe krijojmë tekste	86
Mësimi 27. Mësojmë të ftojme	87
Mësimi 28. Cikli i ujit	89
Mësimi 29. Liqeni i Shasit	91
Mësimi 30. Vëzhguesit e qiellit	93
Mësimi 31. Vallet tona	95
Mësimi 32. Njeriu dhe teknologjia	97
Detyra kontrolli	99
Literaturë	113

Hyrje

Teksti "Udhëtojmë me gjuhën" është hartuar mbi bazën e programit të "Gjuhës shqipe dhe Letërsisë", të miratuar nga Enti i Shkollimit në Mal të Zi (Podgoricë, 2017) dhe vjen i organizuar në tri pjesë: teksti mësimor, fletorja e punës dhe libri i mësuesit. Teksti përmban tre kapituj, "Komunikojmë dhe shkruajmë", "Mësojmë për fjalët dhe fjalitë" dhe "Lexojmë dhe krijojmë tekste".

Libri i nxënësit është menduar jo vetëm si një tekst teorik, por edhe interaktiv, përmes të cilit nxënësit jo vetëm marrin informacionin, por edhe të reagojnë rreth tij. Për ta realizuar këtë qëllim, përveç pyetjeve, janë vendosur edhe disa ushtrime që lidhen me temën që po zhvillohet. Në këtë mënyrë ai harmonizohet natyrshëm me fletoren e punës.

Në kapitullin e parë "Komunikojmë dhe shkruajmë" hap pas hapi nxënësit duke komunikuar njihen dhe mësojnë edhe rregullat në dialog duke filluar me mënyrën se si duhet filluar një bisedë, si të përshëndesim, ku dhe kur duhen përdorur shprehjet, si: Përshëndetje! Mirëdita! Si je? Si shkoi dita sot?; aftësohen për të dhënë përgjigje të plota, të dëgjojnë me vëmendje bashkëbiseduesin etj. Në pjesën më të madhe të mësimave nxënësit hyjnë në ndërveprim me një tekst, i cili u krijon mundësi atyre që të diskutojnë për tema, si pushimet verore, vjeshta etj.

Në mësimet në vijim nxënësit mësojnë se si të ndërveprojnë kur marrin në telefon. Përmes situatave konkrete dhe dialogëve që vetë ata duhet t'i krijojnë, mësojnë e praktikohen për zbatimin e rregullave në bisedat telefonike. Nga dialogu kalohet dalëngadalë në koncepte më të ndërlikuara, si: fjalë, fjali dhe tekst. Njohja e mirë e tyre u krijon mundësi nxënësve, që jo vetëm të njihen me pjesët ndërtuese të tekstit, por u jepet mundësia që ata vetë të krijojnë tekste përmes figurave të ndryshme. Një rëndësi i jepet respektimit të shenjave të pikësimit, si në dialog ashtu edhe në tekst. Problematika e shenjave të pikësimit është rimarrë më gjerësisht sidomos te llojet e fjalive. Me anë të ushtrimeve të larmishme, synohet pikërisht ngulitja e këtyre rregullave dhe krijimi i shprehive në përdorimin e tyre. Një çështje drejtshkrimore e cila ka një hapësirë të veçantë, ka të bëjë me ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. Rregullat e ndarjes së fjalëve, ushtrimet e ndryshme, synojnë jo vetëm njohjen e tyre nga nxënësit, por sidomos zbatimin e tyre. Në shkrimet funksionale përveç urimeve, shkrimit të kartolinave, është përfshirë edhe mënyra se si të lëmë shënime, që i ndihmon ata të bëhen edhe qytetarë të denjë. Koncepte, si gjuhë amtare, gjuhë e huaj, parimet e interkulturalitetit, mendojmë se do ta ndihmojnë nxënësin të bëhet edhe një qytetar evropian. Kapitulli II "Mësojmë për fjalët dhe fjalitë" ka një lami temash e konceptesh. Në këtë kapitull, por jo vetëm në këtë rast, janë përdorur paralelizma, si për mënyrën e ndërtimit të fjalisë, mënyrën e funksionimit të saj etj., ndërtimit të tekstit, duke u dhënë mundësi nxënësve që ta kuptojnë më mirë konceptet gjuhësor duke qenë se një pjesë të tyre, ato i ndeshin për herë të parë. Nxënësit kanë mundësi që të njihen me gjymtyrët kryesore të fjalisë, kryefjalën dhe kallëzuesin, pjesët plotësuese të tyre, për të kaluar në konceptin fjali e zgjeruar. Tema, si "Fjalja dëftore, fjalja pyetëse e fjalja thirrmore" dhe "Mësojmë shenja të tjera të pikësimit" i plotësojnë njohuritë e nxënëve për fjalitë, llojet e tyre dhe rikthehen në vëmendje shenjat e pikësimit, së bashku me disa rregulla të përdorimit të tyre. Kërkesat e ndryshme që lidhen me krijimin e fjalive të ndryshme, të teksteve, identifikimin e shenjës

së duhur të pikësimit, i japin mundësi nxënësve që t'i vënë në praktikë njohuritë teorike të marra. Me anë të temave, si "Mësojmë fjalët që tregojnë njerëz, kafshë ose sende", "Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm", "Gjinia dhe numri i emrit" nxënësit kanë mundësi të marrin njohuri për emrin, tiparet morfologjike të tij, për të kaluar në fjalë që tregojnë tipare të tij. Ushtrimet, lojërat gjuhësore u japin mundësi nxënësve që të ndërlidhin konceptet e emrit me ato të mbiemrit, për të kaluar më pas te fjalët që tregojnë veprime.

Kapitulli III "Lexojmë dhe krijojmë tekste" u jep mundësi më shumë nxënësve që të ushtrohen me tekste joletrare dhe tekste joletrare shkencore. Tema, si "Cikli i ujit", "Vëzhguesit e qiellit" etj., jo vetëm u japin njohuri nxënësve, por i përball ata me një lloj tjetër teksti, tekstin shkencor. Pyetjet, ushtrimet i ndihmojnë nxënësit që të përgjigjen për njohuritë e marra, por edhe të ushtrohen që ata vetë të shkruajnë tekste të kësaj natyre. Në disa raste u janë dhënë ushtrime që ata vetë të hulumtojnë nëpër enciklopedi të ndryshme ose internet për tema të tilla, me qëllim zgjerimin e njohurive, ballafaqimin me këto tekste dhe sprovimin e tyre për të krijuar tekste të kësaj natyre.

Në ndihmë të mësuesit është hartuar dhe "Libri i mësuesit" që do ta ndihmojë atë në organizimin e orës së mësimi. Çdo njësi mësimore vjen me propozime të pasura si për nga metodat e teknikat që propozon, por edhe sa i takon organizimit didaktik të tërë materialit. Në fund janë dhënë edhe disa modele detyrash kontrolli, si një orientim për mësuesin.

Do të ishte mirë të theksohej në Hyrje se përgatitjet nga Manuali janë vetëm sugjerime që mësuesit mund t'i përdorin siç tregohet, pastaj si një model sipas të cilit mund të bëjnë përgatitjet e tyre, por që nuk janë të detyruar t'i ndjekin ato plotësisht, kështu që nuk janë të detyrueshme. Çdo mësues rezervon të drejtën për të shkruar përgatitjen (e tij) ditore, në përputhje me nevojat dhe kushtet e klasës në të cilën jep mësim.

KAPITULLI I PARË
KOMUNIKOJMË DHE SHKRUAJMË
PLANIFIKIME DITORE

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Komunikojmë dhe bashkëbisedojmë

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

të fillojë bisedën dhe të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme ndaj të folurit të tjetrit;

të dëgjojë me kujdes pyetjet dhe të përgjigjet me përgjigje të plota.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: Brainstorming, bisedë, lexim zinxhir, diskutim etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore.

Veprimtaritë e nxënësve:

- bisedojnë dhe komentojnë fotografitë nga pushimet verore;
- dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë;
- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë përmbajtjen e tekstit nga libri i nxënësit;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës.
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri - tjetrit;
- demonstrojnë situata të ndryshme të bisedës në telefon.

Fjalët kyçe: bisedë, dialog, bashkëbisedim.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, fotografi të ndryshme, tabelë, shkumës, kompjuter, CD etj.


ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Brainstorming/ Këndim

Ora e mësimit fillon me këtë aktivitet: Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë "Pushimet verore".

Më pas bisedojnë me njëri - tjetrin për pushimet verore dhe japin mendimet e tyre për plotësimin e skemës.



Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e dytë - Punë në tekstin mësimor

Mësuesi prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Komunikojmë dhe bashkëbisedojmë”**.

Nxënësit lexojnë me kujdes tekstin “Pas pushimeve verore” dhe përgjigjen në rubrikën **“Pyetje”**.

Mësues-i/ja shpjegon dhe i udhëzon nxënësit të mbajnë mend se **Bashkëbisedimi** është biseda që bëhet ndërmjet dy a më shumë vetave, që ndryshe quhet edhe **dialog**.

Veprimtaria e tretë - Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit ngjyrosin përgjigjet e sakta mbi bazën e informacionit të marrë në tekst.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit shkruajnë nga një fjali për Besartin dhe Verën.

Ushtrimi 3. Në mënyrë individuale nxënësit rendisin fjalët sipas alfabetit: **bluzë, çorape, doreza, këpucë** etj.

Ushtrimet 4 dhe 5. Në grupe nxënësit diskutojnë për pushimet dhe shkruajnë nga një fjali për secilën fotografi.

Hapi III - Përfundim

Veprimtaria e katërt - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë ushtrimet 2 dhe 3, sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit rendisin fjalët sipas alfabetit: **akullore, celular** etj.

Ushtrimi 3. Në çifte komentojnë fotografitë e ngjitura nga pushimet.

.....

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Vjeshta në kopshtin tim

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë me vëmendje bashkëbiseduesin, duke mos e ndërprerë gjatë bisedës;
- të zbatojë rregullat e sjelljes së bukur, duke përdorur shprehjet përkatëse;
- të dëgjojë me kujdes pyetjet dhe të përgjigjet me përgjigje të plota.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimimit: Brainstorming, bisedë, lexim zinxhir, diskutim etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore, art figurativ.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- bisedojnë për stinën e vjeshtës;
- dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë;
- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë bisedën e dhënë nga teksti mësimor;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri - tjetrit.

.....
Fjalët kyçe: bisedë, bashkëbisedues, rregullat e bisedës.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, fotografi të ndryshme, tabelë, shkumës, kompjuter, CD, projektor/tv etj.

.....
ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)


Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtari e parë - Brainstorming

Ora e mësimimit fillon me këtë aktivitet: Nxënësit në projektor/televizion shikojnë katër ngjyra (e kaltër, e bardhë, portokalli, e gjelbër) dhe përcaktojnë me cilën stinë lidhen.

pranvera - e gjelbër vera – e kaltër vjeshta – portokalli dimri - e bardhë

Më pas bisedojnë me njëri – tjetrin për stinën e vjeshtës dhe me përgjigjet e tyre mësuesi plotëson skemën.




Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën “Vjeshta”.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e dytë – Punë në tekstin mësimor/ prezentim me projektor

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin “**Vjeshta në kopshtin tim**”.

Nxënësit lexojnë në çifte tekstin (bisedën në mes Anës dhe Lulit) dhe përgjigjen në rubrikën **Pyetje**. Vihet theksi te përdorimi i shprehjeve të mirësjelljes: **të lutem, më fal, faleminderit**. Mësues-i/ja paraqet në projektor/televizion rregullat e bisedës dhe i shpjegon ato.



Veprimtaria e tretë – Punim i ushtrimeve në tekstin mësimor

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në çifte nxënësit lexojnë dialogun në mes dy fëmijëve dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit e rishkruajnë dialogun, në mënyrë që fëmijët të kuptohen dhe në fund e lexojnë.

Hapi III – Përforcim

Veprimtaria e katërt – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në grup punojnë ushtrimet 1, 2 dhe 4, sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Në grupe nxënësit e shkruajnë siç e mendojnë dialogun në mes fëmijëve. Mësuesi mund t'u sugjerojë disa tema bisede. Në fund të punës grupet prezantojnë punën e vet dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale shkruajnë tri fjali për vjeshtën.

Ushtrimi 4. Në grupe nxënësit diskutojnë për situatën e paraqitur dhe argumentojnë pse nuk respektohen rregullat e bisedës. Shprehin mendimet e tyre për zgjidhjen e situatës.

Veprimtaria e pestë – Punë në grupe

Nxënësit në grupe mund të diskutojnë edhe situata të tjera nga përvoja e tyre, ku janë apo nuk janë respektuar rregullat e bisedës.

Mësues-i/ja dëgjon diskutimin në grupe dhe jep sqarime, kur është e nevojshme.

.....

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3 nga fletorja e punës. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Bisedojmë në telefon

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zbatojë rregullat e bisedës në telefon (përshëndetjen, prezantimin).

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimimit: Brainstorming, Di - Dua të di - Mëso-va, lexim zinxhir, shpjegim, demonstrim etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore, art figurativ.

Veprimtaritë e nxënësve:

- bisedojnë për mjetet e komunikimit në mes njerëzve;
- dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë;
- shprehin lirshëm mendimin e tyre për situatat nga jeta e përditshme;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë bisedat telefonike të dhëna nga teksti mësimor;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri - tjetrit;
- demonstrojnë situata të ndryshme të bisedës në telefon.

Fjalët kyçe: telefoni, biseda telefonike, rregullat, numrat e emergjencës.


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurtesë, kompjuter, CD, projektor/tv, mjete vizatimi, mjete konkretizimi etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Brainstorming/Diskutim

Ora e mësimimit fillon me këtë veprimtari: Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe mësues-i/ ja plotëson skemën.



Nxënësit dëgjojnë incizimin e përgatitur nga mësuesi, ku fëmijët në telefon flasin shpejt, bërtasin dhe nuk i përdorin përshëndetjet dhe fjalët magjike: Mirëdita!, Ju lutem!, Më fall!, Faleminderit!, Mirupafshim! etj. Diskutojnë me mësuesin për bisedën e dëgjuar dhe u përgjigjen pyetjeve: Me çfarë mjeti komunikimi po bisedojnë fëmijët? Kush flet? Me kë flet? Çfarë nuk ju pëlqen në këtë bisedë? Si do të vepronit ju në këtë rast?

Veprimtaria e dytë – Di - Dua të di - Mësova

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Bisedojmë në telefon.	Telefoni është mjet komunikimi.	Si lindi telefoni? Kush e shpiku telefonin? Llojet e bisedës në telefon. Rregullat e bisedës në telefon. Numrat e emergjencës.	

Nxënësit plotësojnë dy shtyllat e tabelës (Di- dua të di), kurse mësova në fund të orës së mësimi.


Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e tretë - Punë në tekstin mësimor/prezantim në projektor

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimi dhe shkruan në tabelë titullin **“Bisedojmë në telefon”**.

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe komentojnë tri llojet e bisedës në telefon.

Nxënësit dëgjojnë shpjegimin e mësues-it/es për llojet e bisedave në telefon dhe rregullat që duhen zbatuar (prezantim në projektor/televizion).



Nxënësit zinxhir lexojnë dhe komentojnë së bashku me mësues-in/en tekstin “Si lindi telefoni”. Njihen me numrat e emergjencës: 122 (policia), 123 (zjarrfikësit), 124 (urgjenca).

Veprimtaria e katërt – Punë në grupe

Nxënësit në grupe tregojnë situata nga jeta e përditshme, kur ata apo të afërmit e tyre i kanë telefonuar policisë, zjarrfikësve apo urgjencës.

Gr. 1. Policia

Gr. 2. Zjarrfikësit

Gr. 3. Urgjenca

Mësues-i/ja dëgjon punën e nxënësve në grupe dhe jep sqarime, nëse e sheh të nevojshme.

Veprimtaria e pestë - Punohen ushtrimet në tekstin mësimor

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në çifte diskutojnë me njëri - tjetrin situatën e komunikimit me celular.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit plotësojnë dialogun me fjalët e dhëna dhe në fund e lexojnë.

Hapi III - Përforcim


Veprimtaria e gjashtë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë ushtrimet 1 dhe 2, sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale, nxënësit plotësojnë dialogët e dhënë. Në fund të punës i lexojnë dhe komentojnë.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit zbulojnë fjalët: telefon, bisedë, celular, komunikoj, valë. Punimi i detyrave komentohet me mësues-in/en dhe shokët.

Rubrika - Mësojmë dhe zbavitemi



Ushtrimi 4. Nxënësit në grupe krijojnë telefonin dhe më pas demonstrojnë situata të ndryshme të bisedës telefonike me shokun/shoqen.

Ushtrimi 5. Nxënësit në grupe luajnë lojën "Telefoni i prishur" duke zbatuar rregullat e lojës. Dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë "Telefoni".

.....

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3 nga fletorja e punës. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Fjala, fjalia dhe teksti

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shkruajë tekste me strukturë të thjeshtë në përshtatje me temën e dhënë apo të përgjedhur sipas dëshirës

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: loja e fjalëve, punë e drejtuar, marrëdhënie pyetje - përgjigje, turi i galerisë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore, art figurativ.

Veprimtaritë e nxënësve:

- krijojnë fjali duke luajtur me etiketa fjalësh;
- identifikojnë fjalën, fjalinë dhe tekstin;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë tekstet e dhëna nga teksti mësimor;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit;
- dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë.

Fjalët kyçe: fjalë , fjali, tekst, rendit, dallo, formo, etj.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurtes, kompjuter, CD, projektor/tv, mjete vizatimi, fisha me fjalë, fjali, figura të ndryshme etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë. Loja e fjalëve me fisha.

Nxënësit të ndarë në grupe tërheqin mbi tavolinën e mësuesit zarfin me fshat e fjalëve. Me këto fisha nxënësit krijojnë fjalinë:

Pjetri

panair

shkoi

me

në

gjyshin

Pas përfundimit të punës çdo grup lexon fjalinë e krijuar.

Mësues-i/ja dëgjon me vëmendje leximin e fjalive të krijuara nga nxënësit në grupe dhe plotëson tabelën.

Shembull

Fjali	Jo - fjali
Pjetri shkoi me gjyshin në panair.	Panair për Pjetri shkoi me gjyshin.

Nxënësit së bashku me mësuesin dallojnë pasaktësinë e formimit të fjalive (fjalët nuk janë radhitur sipas kuptimit).

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e dytë - Marrëdhënie pyetje - përgjigje

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Fjala, fjali dhe teksti”**.

Dy nxënës ngrihen në tabelë dhe shkruajnë këto fjali:

Zogu cicëron.

Gjyshi i bleu Pjetrit në panair libra me përralla.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve tjerë të lexojnë në heshtje fjalitë dhe të dallojnë cila fjali ka lidhje me fjalinë që krijuam më parë. Ata duhet të përgjigjen: ***Gjyshi i bleu Pjetrit disa libra me përralla.***

Fjali + fjali = tekst

Duke u bazuar në shembujt lart mësues-i/ja shpjegon:

Fjalja krijohet nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve që lidhen nga kuptimi. Fjalja fillon me shkronjë të madhe dhe mbaron me një shenjë pikësimi, si pika, pikëpyetja etj.

Teksti përbëhet nga dy ose më shumë fjali të lidhura fort me njëra-tjetrën. Pjesët e tekstit janë: hyrja, zhvillimi dhe mbyllja.

Veprimtaria e tretë - Punë në tekstin mësimor.

Nxënësit lexojnë zinxhir tekstin “Shkolla e re” dhe përgjigjen në rubrikën **“Pyetje”**.

Lexojnë, komentojnë dhe dallojnë së bashku me mësuesin pjesët e tekstit tek **Krijojmë tekste sipas figurave**.

Punimi i ushtrimeve në tekst

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale, nxënësit shënojnë me \surd grupet e fjalëve që krijojnë një fjali.

Ushtrimi 2. Në çifte, nxënësit u vendosin fjalive nga një numër që të formojnë një tekst. Tekstin e plotë e shkruajnë në fletore.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Veprimtaria e katërt - Punë në grupe

Nxënësit të ndarë në grupe formojnë nga një tekst me fishat e dhëna nga mësuesi (Çdo grup punon nga 3 - 5 fisha me fjali). Në fund të punës drejtuesit e grupeve prezantojnë para klasës punën e grupeve të tyre, duke lexuar tekstet e formuara.

Mësues-i/ja dëgjon punën e nxënësve në grupe dhe jep sqarime, nëse e sheh të nevojshme.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e pestë – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Në grupe nxënësit rendisin fjalët dhe krijojnë fjali. Fjalinë e shkruajnë në trenin e fjalëve, të cilin pastaj do ta ngjisin në këndin e gjuhës. Mbas përfundimit të punës, nxënësit komentojnë punën e njëri - tjetrit.

Shembull: Lepuri vrapon shumë shpejt. Ne shkuam në piknik.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit shikojnë figurat dhe u përgjigjen pyetjeve.

Shembull: Ky është Albani.
Albani po luan basketboll.
Albanit i pëlqen shumë basketbolli.

Ushtrimi 3. Në mënyrë individuale nxënësit krijojnë nga një tekst të shkurtër për secilën figurë.

Ushtrimi 4. Në çifte nxënësit lidhin pjesën me figurën që i përshtatet. Krahasojnë ditën e Adelinës me ditën e tyre.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Veprimtaria e gjashtë - Punë në grupe

Nxënësit të ndarë në 4 ose 5 grupe formojnë fjali me fishat e fjalëve dhe i shkruajnë ato në një fletë format (Fishat përgatiten nga mësuesi). Çdo grup formon nga një fjali. Në fund në tabelë ngjisin fletët format me fjalitë e formuara dhe krijojnë një tekst për shkollën e tyre. Dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë "Shkolla ime".

.....
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5 nga fletorja e punës. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- t'i ndajë ashtu si duhet fjalët në fund të rreshtit.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimin: loja "Roboti", punë e drejtuar, loja e rrokjeve, Di - dua të di – mësova , shpjegim etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: matematikë, natyrë dhe teknikë.

Veprimtaritë e nxënësve:

- ndajnë fjalët në fund të rreshtit sipas rregullave gjuhësore;
- manipulojnë me rrokje për të formuar fjalë njërrrokëshe, dyrrrokëshe etj;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: zanore, bashkëtingëllore, rrokje, fjalë etj.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë – Loja "Roboti"

Katër nxënës imitojnë robotin duke thënë fjalët: **babi, pëllumbi, flutura, telefoni.**

Një nxënës shkruan në tabelë fjalët e thëna nga roboti (katër nxënësit).

ROBOTI 1 ba – bi

Mësues-i/ja: Sa rrokje ka fjala? Pse?

ROBOTI 2 pë – llu – mbi

Mësues-i/ja: Sa rrokje ka fjala? Pse?

ROBOTI 3 flu- tu – ra

Mësues-i/ja: Sa rrokje ka fjala? Pse?

ROBOTI 4 te – le – fo – ni

Mësues-i/ja: Sa rrokje ka fjala? Pse?

Rregulla: Fjala përbëhet nga një ose disa rrokje. Rrokja formohet nga një zanore dhe një a disa bashkëtingëllore ose edhe nga një zanore e vetme. Fjalët ndahen në rrokje sipas numrit të zanoreve.

Veprimtaria e dytë - Punë në çifte / Lojë

Nxënësit lëvizin nëpër klasë. Në momentin që mësuesja përplas duart, nxënësit formojnë çifte me shokun/shoqen që kanë pranë. Më pas formojnë fjalë të ndryshme dyrrokëshe, sipas kësaj rregulle: Nxënësi i parë thotë një rrokje, kurse i dyti formon një fjalë duke thënë rrokjen tjetër.

Shembull: | || | || | ||
to – ka, ba – nka, ça – nta,

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit”**.

Veprimtaria e tretë - Di - Dua të di - Mësova

Nxënësit të nxitur nga pyetjet e mësuesit plotësojnë dy shtyllat e tabelës DI - DUA TË DI. Shtylla MËSOVA plotësohet në fund të orës nga nxënësit.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Të ndaj fjalët në rrokje. Se fjalët janë: njërrrokëshe, dyrrokëshe etj.	Kur ndahet fjala në fund të rreshtit? Cilat janë rregullat për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit?	

Veprimtaria e katërt

Mësuesi paraqet në projektor fragmentin “Toni dhe biçikleta”. Pasi lexohet dhe komentohet teksti, veçohen fjalët që janë ndarë në fund të rreshtit: **mën - gjes, fi – llojë, së bash-ku, argëto-hem**. Si janë ndarë këto fjalë në fund të rreshtit? Cilat fjalë janë ndarë saktë? Pse? Cilat fjalë janë ndarë gabim? Pse?

Duke u bazuar në shembujt lart mësues-i/ja shpjegon:

RREGULLAT E NDARJES SË FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT:

1.Fjalët mund të ndahen sipas rrokjeve.

de-ti ba – na – ne dri – ta – re

Ndarjen e fjalëve me tri rrokje në fund të rreshtit mund ta bëjmë edhe në këto mënyra:

ba-nane ose bana-ne dri – tare ose drita – re

2. Bashkëtingëlloret: dh, gj, nj, rr, sh, th, xh, zh nuk ndahen asnjëherë nga njëra – tjetra.

mo – lla √ mol-la X

3.Fjalët njërrrokëshe nuk ndahen në fund të rreshtit: **dru, lis, mik, shok, shkëmb** etj.

4.Në fund të rreshtit nuk lihet asnjëherë një shkronjë e vetme edhe nëse është një zanore.
Shembul: **era √ e – ra X**

Veprimtaria e pestë - Punimi i ushtrimeve në tekst.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë rubrikën e ushtrimeve nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit shënojnë me **S** përgjigjen e saktë (b) dhe **G** atë

të gabuar (a, c, d).

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit shënojnë me **X** fjalët e ndara gabim (u-ra, yl-li, top, shkol-lë, gur, das-hi). Argumentojnë përgjigjet e tyre.

Ushtrimi 3. Në mënyrë individuale nxënësit ndajnë në fund të rreshtit fjalët e nënvizuara.

Shembull: ki – nema kine- ma bre- dhi to – pi sa – punin sapu – nin

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e gjashtë – Punë në fletore pune


Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 2, 3 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit rishkruajnë fjalitë duke rregulluar fjalët që janë ndarë gabim.

Shembull: Retë e zeza në qiell paralajmëronin një stuhi të ma - dhe.

Ushtrimi 3. Nxënësit në grupe ndajnë në dy mënyra fjalët në fund të rreshtit sipas modelit. Tek ky ushtrim mund të merren edhe shembuj të tjerë, që të punohen nga nxënësit në grupe.

Ushtrimi 4. Në çifte nxënësit gjejnë fjalët: **shkollë, yll, dashi, dhurata.**



Veprimtaria e shtatë - Punë në grupe / Lojë

Nxënësit të ndarë në grupe shënojnë në një letër të bardhë nga një fjalë që u vjen ndërmend dhe e palosin fletën në formë fizarmonike duke e kaluar te shoku që kanë pranë. Në fund përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e grupit të vet. Mësues-i/ja së bashku me nxënësit diskutojnë ndarjen e fjalëve. Shpallet grupi fitues.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 dhe 5 nga fletorja e punës. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Letra dhe kartolina

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shkruajë tekste me përmbajtje të ndryshme: letër, kartolinë, urim etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimimit: stuhi mendimesh, shkrim i lirë, punë e drejtuar, shpjegim, truri i galerisë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kultura muzikore, arti figurativ.

Veprimtaritë e nxënësve:

- identifikojnë llojet e letrave dhe kartolinave;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: letër, postë , postë elektronike, kartolinë, kompjuter, zarf, postoj, postier etj.


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, letër, kartolinë, zarf etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Stuhi mendimesh

Ora e mësimimit fillon me këtë veprimtari: Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe mësuesi plotëson skemën. Disa nga përgjigjet e nxënësve mund të jenë këto:



Mësues-i/ja mund të vazhdojë bisedën me nxënësit duke i nxitur me këto pyetje: Cilin mjet komunikimi përdorni më shpesh? Pse? Po prindërit tuaj? A keni dërguar apo fituar ndonjëherë letër? Nëse po, kujt ia keni dërguar? Ku e keni nisur letrën? etj.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Letra dhe kartolina”**.

Veprimtaria e dytë - Punë e drejtuar

Mësues-i/ja paraqet në projektor dy modele letrash (letër personale dhe letër zyrtare). Letrat lexohen dhe komentohen së bashku me nxënës. Nxënësit dallojnë pjesët përbërëse të letrës: **hyrjen, përmbajtjen e letrës, mbylljen dhe dërguesin.**

Mësues-i/ja përmes Diagramit të Venit mund të shpjegojë dallimin në mes letrës që dërgojmë në postën e zakonshme dhe letrës elektronike.

Mësues-i/ja paraqet në projektor dy modele kartolinash (kartolinën tradicionale dhe kartolinën elektronike). Kartolinat lexohen dhe komentohen së bashku me nxënës.

Veprimtaria e tretë - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit lexojnë e komentojnë letrën e kartolinën e dhënë në tekstin mësimor dhe përgjigjen në rubrikën **“Plotësoni”**.

Lexohet dhe komentohet së bashku me nxënës teksti “Historia e kartolinës”.

Veprimtaria e katërt - Punimi i ushtrimeve në tekst

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në çifte nxënësit qarkojnë përgjigjet e sakta.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit shkruajnë një letër. Nxënësit mund të udhëzojnë rreth temës së letrës. Mbas përfundimit të detyrës, mund të lexohen disa letra dhe të komentohen me nxënës.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e pestë – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 2, 3 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit i shkruajnë shokut/shoqes një kartolinë.

Ushtrimi 3. Në çifte nxënësit lexojnë letrën dhe plotësojnë elementet që i mungojnë.

Ushtrimi 5. Në grupe nxënësit krijojnë nga një kartolinë për mësuesin/mësuesen. Në përfundim të punës, çdo përfaqësues i grupit paraqet punën e grupit të vet. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën “Kec postieri”.

Vrejtje: Për këtë temë mund të bëhet vizitë në postë.

.....

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 dhe 4 nga fletorja e punës. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Urojmë dhe mësojmë të lëmë shënime

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shkruajë tekste me përmbajtje të ndryshme: letër, kartolinë, urim etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimin: lojë, punë e drejtuar, shpjegim, Di - Dua të di - Mësova etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- identifikojnë urimet dhe shënime;
- dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë;
- lexojnë dhe komentojnë urimet dhe shënime e dhëna në tekstin mësimor;
- punojnë në mënyrë individuale dhe në çifte ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre në grupe dhe diskutojnë punën e njëri - tjetrit.

.....
Fjalët kyçe: urim, uroj, fjali me të cilat urojmë, shënime etj.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurtesë, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë – Lojë

Nxënësit fusin në kuti dorën dhe marrin fisha, në të cilat janë shkruar këto fjali (situata):

Sot Ardi feston ditëlindjen.

Albani nesër do të shkojë në Gjermani.

Teuta zuri vendin e parë në garat e recitimit.

Nëna feston 8 Marsin.

Petritit i ka lindur djali.

Nxënësit e tjerë thonë urimet për situatat e krijuara.

Shembull: Sot Ardi feston ditëlindjen.

Gëzuar ditëlindjen Ardi! U bëfsh 100 vjeç!

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën "Shumë urime për ty".

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Urojmë dhe mësojmë të lëmë shënime”**.

Veprimtaria e dytë - Di - dua të di -mësova

Nxënësit të nxitur nga pyetjet e mësuesit plotësojnë dy shtyllat e tabelës DI - DUA TË DI. Shtylla MËSOVA plotësohet në fund të orës nga nxënësit.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Të bëj urime me gojë.	Si të bëj urime me shkrim? Çfarë vendoset në fund të urimeve? Çfarë janë shënimet? Cilat janë funksionet e shënimeve?	

Veprimtaria e tretë - Punë e drejtuar

Mësues-i/ja paraqet me projektor shembuj urimesh e shënimesh dhe i komenton ato me nxënës. Mbi bazën e shembujve shpjegon rregullat e shkrimit të urimeve dhe shënimeve.

Veprimtaria e katërt - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit lexojnë e komentojnë urimet e shënimet e dhëna në tekstin mësimor dhe përgjigjen në rubrikën **Pyetje**.

Veprimtaria e pestë - Punimi i ushtrimeve në tekst

Nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Shkruajnë dy urime, që u kanë mbetur në mendje. Më pas i diskutojnë me shokët.

Ushtrimi 2. Shënojnë dy tipare të shënimeve.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e gjashtë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë ushtrimet 1, 3 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit shkruajnë një urim për ditëlindjen e Jasminës.

Ushtrimi 3. Në çifte nxënësit qarkojnë përgjigjet e sakta dhe argumentojnë pse.

Ushtrimi 5. Në mënyrë individuale nxënësit shkruajnë një shënim për motrën apo vëllanë më të madh. Lexohen disa prej shënimeve.

Nxënësit të ndarë në grupe, punojnë detyrat e përcaktuara nga mësuesi.

Gr.1 - Shkruaj një urim shokut/shoqes për vendin e parë në garat shtetërore.

Gr.2 - Shkruaj një urim mësuesit/mësueses për 7 Marsin.

Gr.3 - Shkruaj një urim familjes, që po kthehen nga mërgimi të jetojnë në vendlindje.

Gr.5 - Shkruaj shënim gjyshes për të zgjuar herët në mëngjes.

Në përfundim të punës, çdo përfaqësues i grupit paraqet punën e grupit të vet. Vlerësohet puna e bërë në grupe. Shpallet grupi më i mirë.

.....
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 2 dhe 4 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.
Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Tregojmë dhe shkruajmë sipas figurave

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shkruajë tekste me strukturë të thjeshtë në përshtatje me temën e dhënë apo të përzgjedhur sipas dëshirës

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: stuhi mendimesh, punë e drejtuar, shkrim i lirë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore

Veprimtaritë e nxënësve:

- krijojnë me gojë dhe me shkrim tregime mbi bazën e figurave;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë tekstet e dhëna nga teksti mësimor;
- punojnë në mënyrë individuale dhe në çifte ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre në grup dhe diskutojnë punën e njëri - tjetrit;
- dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë.

Fjalët kyçe: tregim sipas figurave


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi etj.

**ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)**

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - këngë / stuhi mendimesh

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë“ Miku im”. Më pas e komentojnë atë me mësues-in/en dhe plotësojnë skemën .



Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e dytë - Punë e drejtuar

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Tregojmë dhe shkruajmë sipas figurave”**.

Paraqet në projektor tekstin joletrar “Miqësia”, të cilin e lexon dhe e komenton me nxënës.

Veprimtaria e tretë - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit të ndarë në grupe krijojnë me gojë një tregim mbi bazën e figurave të dhëna në tekst. Mbas përfundimit të punës çdo përfaqësues i grupit prezanton punën e grupit të vet. Mësues-i/ja dëgjon punën e nxënësve në grupe dhe jep sqarime, nëse e sheh të nevojshme.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e tretë – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë ushtrimet 2, 3 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale shkruajnë dy fjali për miqësinë.

Ushtrimi 3. Në çifte nxënësit krijojnë nga një fjali për secilën prej figurave.

Ushtrimi 4. Në mënyrë individuale nxënësit i shkruajnë një letër mikut të tyre.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

.....
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Flasim gjuhë të ndryshme

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të kuptojë dhe të krahasojë nocionet gjuhë amtare (gjuha standarde dhe gjuha jostandarde), gjuhë zyrtare dhe gjuhë e huaj.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: lojë, punë e drejtuar, shpjegim, bisedë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore, matematikë.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- identifikojnë gjuhën amtare (gjuhën standarde dhe jostandarde), gjuhën zyrtare, gjuhën e huaj;
- dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre në grupe dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

.....
Fjalët kyçe: gjuhë amtare (gjuhë standarde, gjuhë jostandarde), gjuhë zyrtare etj.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, CD, mjete vizatimi etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - këngë/bisedë

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën "Gjuha jonë". Më pas e komentojnë atë me mësues-in/en. Për të nxitur bisedën, mësues-i/ja mund t'u drejtojë këto pyetje: Kujt i kushtohet kjo këngë? Cilën gjuhë ne flasim? Çfarë është gjuha shqipe për ne? Çfarë gjuhe tjetër mësoni në shkollë? A i dini ato gjuhë si gjuhën shqipe? Pse? Po bashkëmoshatarët tuaj në paralelet në gjuhë malazeze çfarë gjuhe flasin ? Pse? etj.

Veprimtaria e dytë - Punë në grupe

Nxënësit të ndarë në grupe punojnë detyrat e përcaktuara nga mësues-i/ja. Çdo grup merr nga një zarf me fjalë të ndryshme. Detyra e grupeve është të ndajnë fjalët në dy bashkësi (grupe):

1. Fjalë që i përdorin në shtëpi ose me shokët jashtë shkollës.
2. Fjalë që i përdorin në shkollë apo që kanë dëgjuar në televizion.

Në përfundim të punës, çdo përfaqësues i grupit prezanton punën e grupit të vet. Mësues-i/ja përcjell me vëmendje prezantimin e punës së nxënësve në grupe dhe ndërhyr nëse e shikon të nevojshme.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin “**Flasim gjuhë të ndryshme**”.

Veprimtaria e tretë - Punë e drejtuar

Duke u bazuar në tekstin “ Flasim gjuhë të ndryshme” dhe shembujt lart, mësues-i/ja shpjegon:

Gjuha amtare është gjuha që ne e mësojmë në familje dhe e përdorim kur flasim me prindërit, me gjyshin ose gjyshen dhe të afërmit tonë. Gjuha jonë amtare është **gjuha shqipe**. Çdo komb ka gjuhën e vet amtare.

Më 21 shkurt festohet çdo vit në mbarë botën Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare.

Gjuha standarde është gjuha që përdoret në shkollë, në institucione shtetërore, në median e shkruar dhe atë të folur etj.

Gjuha jostandarde përfshin dialektet e variante të tjera gjuhësore. Dialekte kryesore të shqipes janë gegërishtja dhe toskërishtja. Zakonisht është gjuha që ne përdorim në shtëpi, me shokët jashtë shkollës etj.

Gjuha zyrtare është gjuha e shtetit ku ne jetojmë, është gjuha që përdoret në institucionet shtetërore dhe për punë zyrtare.

Veprimtaria e katërt - Punimi i ushtrimeve në tekst.

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale plotësojnë fjalitë.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale kthejnë në gjuhën standarde shprehjen e dhënë.

Bëje vrapin, sa ke hapin.

Ushtrimi 3. Çdo grup komenton nga një foto.

Ushtrimi 4. Nxënësit në çifte për çdo fjalë të dhënë shkruajnë nga një fjalë përgjegjëse në gjuhën tjetër.

Shembull: Përshëndetje - Zdravo **ose** Përshëndetje - Hi!

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e gjashtë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 3, 4 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 3 - Punë në grupe (propozim)

Gr 1. - Shkruajnë tekstin (Përshëndes shoqen time) në gjuhë standarde.

Gr. 2 - Shkruajnë tekstin (Bëj pazar në Podgoricë) në gjuhë standarde.

Gr.3 - Shkruajnë tekstin (Përshëndes shoqen time) në gjuhë jostandarde.

Gr.4 - Shkruajnë tekstin (Bëj pazar në Podgoricë) në gjuhë jostandarde.

Në fund grupet prezantojnë punën e tyre. Shpallet grupi fitues.

Ushtrimi 4. Duke punuar në çifte nxënësit kthejnë fjalitë e dhëna në gjuhën standarde.

Shembull:	Nana jeme asht shoqja ma e mirë.	Zani shkoi larg.
	Nëna ime është shoqja më e mirë.	Zëri shkoi larg.

Ushtrimi 5. Nxënësit në mënyrë të pavarur krijojnë një tekst të shkurtër me temë "Unë flas...". Lexohen disa punime të nxënësve.

Vepriimtaria e shtatë - Lojë

Mësues-i/ja paraqet në projektor disa fjalë në gjuhën shqipe dhe disa fjalë në gjuhë të tjera (gjuhë malazeze, gjuhë angleze) dhe kërkon nga nxënësit që në duar të mbajnë fletët me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë.

Kur mësues-i/ja lexon fjalën, nxënësit e ngrejnë letrën e kuqe lart, nëse fjala është në gjuhën shqipe dhe të verdhë nëse është në gjuhë të tjera.

Kjo lojë mund të ndiqet edhe për fjalët në gjuhën standarde dhe jostandarde.

.....
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 1 edhe 2 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

KAPITULLI I DYTË

MËSOJMË PËR FJALËT DHE FJALITË

PLANIFIKIME DITORE

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Pjesët kryesore të fjalisë

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë dhe të krahasojë pjesët kryesore dhe plotësuese të fjalisë.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimin: stuhi mendimesh, loja e fjalëve, marrëdhënie pyetje - përgjigje, analizë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri

Veprimtaritë e nxënësve:

- manipulojnë me etiketa fjalësh dhe krijojnë fjali;
- identifikojnë kryefjalën dhe kallëzuesin në fjali dhe tekst;
- analizojnë fjalitë;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: pjesët kryesore, kryefjala, kallëzuesi etj.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurtes, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, fisha me fjalë etj.


ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Stuhi mendimesh

Ora e mësimin fillon me këtë veprimtari: Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe mësues-i/ja plotëson skemën. Për të nxitur mendimin e nxënësve, mësues-i/ja mund t' u drejtojë pyetjet:

- Ç'dini për kompjuterin?



– A dini ta përdorni kompjuterin? Për çfarë e përdorni? Sa kohë kaloni në kompjuter? etj.
Veprimtaria e dytë - Punë në grupe / Loja e fjalëve

Nxënësit në grupe formojnë fjali me etiketat e përgatitura nga mësuesi. Çdo grup do të formojë nga një fjali duke i renditur etiketat sipas rendit të duhur. Në fund çdo përfaqësues i grupit paraqet para klasës fjalinë e krijuar. Mësuesi përcjell me vëmendje punën e nxënësve dhe i ndihmon, nëse e sheh të nevojshme.

Shembull fjalish:

Kompjuteri punon.
 Unë luaj në kompjuter.

Në kompjuter Aldo mëson anglisht.
 Teuta fitoi dhuratë një kompjuter të ri.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e tretë - Marrëdhënie pyetje - përgjigje / Analizë

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Pjesët kryesore të fjalisë”**.

Analizohen fjalitë e krijuara nga nxënësit.

Shembull


Kompjuteri punon.



Pyetjet që u drejton mësues-i/ja:

Kush punon? → kompjuteri
 Ç'bën kompjuteri? → punon

Në kompjuter **Aldo mëson** anglisht.



Pyetjet që u drejton mësues-i/ja:

Kush mëson? → Aldo
 Ç'bën Aldo? → mëson

Duke u bazuar në shembujt lart mësues-i/ja shpjegon:

Kryefjala dhe kallëzuesi janë pjesët kryesore të fjalisë.
 Kryefjala tregon për kë flitet në fjali. Ajo gjendet me pyetjet: Kush?, Cili?, Cila? etj.
 Kallëzuesi tregon se Ç'bën kryefjala. Ai gjendet me pyetjet: 'bën?, Ç'bëjnë? etj.

Veprimtaria e katërt - Punimi i ushtrimeve në tekst

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit shënojnë me \surd bashkimet e fjalëve që krijojnë fjali me kuptim.

Shembull:

v Vëllai im ka një top.

v Gjyshja bëri një tortë të shijshme.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit lidhin me shigjetë kryefjalën me kallëzuesin.

Shembull:

1. Hëna shkëlqen në qiell.
2. Qeni luan në kopsht.
3. Mami bëri një tortë.
4. Mësuesja shkruan në tabelë.

Ushtrimi 3. Nxënësit në grupe krijojnë katër fjali sipas ilustrimeve. Në fund lexojnë fjalitë e krijuara.

Ushtrimi 4. Në çifte nxënësit gjejnë kryefjalën në fjalitë e dhëna dhe pastaj e zëvendësojnë atë me një kryefjalë tjetër.

Shembull:

1. Plava ndodhet në Malin e Zi.
 - Ajo ndodhet në Malin e Zi.
- Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Veprimtara e pestë - Punë në grupe

Nxënësit ndahen në 4 grupe. Gr. 1 shkruan një ose dy fjali në një fletë dhe ia jep gr. 2 dhe anasjelltas. Gr. 3 shkruan një ose dy fjali në një fletë dhe ia jep gr.4 dhe anasjelltas. Në fjali ata gjejnë kryefjalën dhe kallëzuesin. Në fund çdo grup prezanton punën e tij para klasës. Mësues-i/ja dëgjon punën e nxënësve në grupe dhe jep sqarime, nëse e sheh të nevojshme. Shpallet grupi më i mirë.

Hapi III - Përforcim**Veprimtaria e gjashtë** - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë ushtrimet 2, 3 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit vendosin kryefjalët që duhen për secilën fjali.

Shembull:

1. Era fryn me furi.
2. Vajza kërcen.
3. Gjethet kanë rënë.

Ushtrimi 3. Në çifte nxënësit shënojnë me X fjalitë te të cilat kryefjala nuk i përgjigjet kallëzuesit.

Shembull:

- a. Kompjuteri është zog.
- b. Shkolla vrapon.
- c. Shtëpia është libër.

Ushtrimi 4. Në mënyrë individuale nxënësit bëjnë nga një vizatim për fjalitë e dhëna.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

.....
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrim 1 dhe 5 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Pjesët plotësuese të fjalisë

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë dhe të krahasojë pjesët kryesore dhe plotësuese të fjalisë.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mëimit: parashikim me terma paraprakë, Di - Dua të di - Mësova, punë e drejtuar, analizë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri.

Veprimtaritë e nxënësve:

- krijojnë fjali mbi bazën e figurave;
- identifikojnë në fjali pjesët plotësuese të kryefjalës dhe kallëzuesit me ndihmën e pyetjeve;
- analizojnë fjalitë;
- punojnë në mënyrë individuale dhe në çifte ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: pjesët kryesore, pjesët plotësuese etj.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Parashikim me terma paraprake

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes fotot e paraqitura në projektor dhe formojnë fjali të përbëra nga kryefjala dhe kallëzuesi.

a) Flutura fluturon.

kryefjala kallëzuesi

b) Fëmijët luajnë.

kryefjala kallëzuesi

c) Vajza shkruan.

kryefjala kallëzuesi

Mësues-i/ja me anë të pyetjeve synon që të zgjerojë fjalitë e mësipërme. Fjalitë e krijuara shkruhen në tabelë duke i dalluar me ngjyra pjesët kryesore nga ato plotësuese të fjalisë.

Fotoja e parë

- Cila flutur? - E verdhë
- Ku fluturon? - Mbi lule

Flutura e verdhë fluturon mbi lule.

Fotoja e dytë

Ku luajnë ? - Në oborr
Kur luajnë? - Në drekë
Me kë luajnë? - Me top

Në drekë fëmijët luajnë në oborr me top.

Kështu vepohet edhe me foton e tretë.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin “**Pjesët plotësuese të fjalisë**”.

Veprimtaria e dytë - Di - Dua të di - Mësova

Nxënësit të nxitur nga pyetjet e mësuesit plotësojnë dy shtyllat e tabelës DI - DUA TË DI. Shtylla MËSOVA plotësohet në fund të orës nga nxënësit.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Cilat janë pjesët kryesore të fjalisë? Çfarë janë kryefjala dhe kallëzuesi? Me cilat pyetje gjenden?	Çfarë janë pjesët plotësuese të fjalisë? Me cilat pyetje gjenden? A mund të qëndrojë fjalia pa pjesët plotësuese?	

Veprimtaria e tretë - Punë e drejtuar / analizë

Analizohen fjalitë e krijuara nga nxënësit. Mësues-i/ja për çdo fjalë në fjali u drejton nxënësve pyetjen e duhur.



Kështu vepohet edhe me fjalitë e tjera.

Duke u bazuar në shembujt lart mësues-i/ja shpjegon:

Fjalët që plotësojnë kryefjalën quhen pjesa plotësuese e kryefjalës.
Fjalët që plotësojnë kallëzuesin quhen pjesa plotësuese e kallëzuesit.
Fjalia mund të qëndrojë pa pjesë plotësuese.

Veprimtaria e katërt – Punë në tekstin mësimor

Nxënësit lexojnë shembujt e dhënë në tekst dhe i analizojnë ata me mësues-in/en.

Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit plotësojnë përkufizimet e dhëna.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit vendosin fjalët plotësuese për secilën kryefjalë dhe i rishkruajnë fjalitë e formuara.

Shembull:

Motra e vogël shkon në kopsht.

Libri i Albës më pëlqeu shumë.

Ushtrimi 3. Nxënësit në çifte lexojnë fjalitë dhe gjejnë pjesët plotësuese të kryefjalës dhe të kallëzuesit.

Shembull:

Ana e vogël ka ditëlindjen.

e vogël → pjesë plotësuese e kryefjalës ditëlindjen → pjesë plotësuese e kallëzuesit.

Ushtrimi 4. Në mënyrë individuale nxënësit plotësojnë tabelën me pyetjet e duhura.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e pestë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë ushtrimet 1, 2 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit plotësojnë përkufizimet e dhëna.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit vendosin fjalët plotësuese për secilin kallëzues.

Zgjidhjet i diskutojnë me shokët.

Shembull:

Ana lexon bukur.

Mësuesja na mëson përrallën.

Ushtrimi 4. Në çifte nxënësit plotësojnë vendet bosh me fjalët e dhëna plotësuese. Lexohen fjalitë e krijuara nga nxënësit.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Veprimtaria e gjashtë - Punë në grupe

Nxënësit të ndarë në grupe punojnë ushtrimet e dhëna nga mësuesi. Çdo grup punon ushtrimet me kërkesa të ndryshme.

Gr.1 Nxënësit gjejnë në fjali pjesët kryesore dhe plotësuese.

Gr.2 Nxënësit u shtojnë pjesëve kryesore të fjalisë pjesët plotësuese.

Gr.3 Nxënësit plotësojnë fjalitë e tekstit me pjesët kryesore e plotësuese të duhura.

Gr.4 Nxënësit krijojnë fjali mbi bazën e figurave dhe në fjalitë e krijuara nënvizojnë me ngjyra të ndryshme pjesët kryesore dhe plotësuese të fjalisë.

Në fund përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre. Mësues-i/ja përcjell me vëmendje prezantimet dhe, nëse ka gabime kërkon që ato të përmirësohen nga grupet e tjera. Shpallet grupi fitues mbi bazën e kriterëve të vendosura në fillim të punës.

.....

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e zgjeruar

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë dhe të krahasojë fjalinë e thjeshtë dhe fjalinë e zgjeruar.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimimit: loja e fjalëve, punë e drejtuar, analizë-shpjegim, shkrim i lirë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë.

Veprimtaritë e nxënësve:

- formojnë fjali me dy fjalë me etiketat e dhëna përmes lojës;
- dallojnë fjalitë e thjeshta dhe të zgjeruara në shembujt e dhënë;
- kthejnë fjalitë e thjeshta në të zgjeruara dhe në të kundërtën;
- punojnë në mënyrë individuale dhe në çifte ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri - tjetrit.

Fjalët kyçe: fjalja e thjeshtë, fjalja e zgjeruar etj.


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, mjete vizatimi, pako me etiketa fjalësh, projektor/tv, tabak letre etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Lojë

Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe në momentin që mësuesja përplas duart ata formojnë çiftet. Detyra e çifteve është të krijojnë fjali të përbëra nga kryefjala dhe kallëzuesi me etiketat me ngjyra, të cilat nxënësit i marrin në dy pakot e vendosura mbi tavolinën e mësuesit. Pakot janë të hapura.



KRYEFJALA



KALLËZUESI

Shembull fjalish:

Babai punon.
Moraça është një lumë.

Genti lexon.
Futbollistët luajnë.

Shembull jofjalish:

Motra është

Taulanti dërgon

Tomi bën

Era shpërndan

Mësues-i/ja së bashku me nxënës diskutojnë pse këto nuk janë fjali. Shndërrojnë jofjalitë në fjali me ndihmën e pyetjeve.

Motra është...

ku?

Motra është **në shkollë.**

Taulanti dërgon...

kë?

Taulanti dërgon **kartolinën.**

Tomi bën...

çfarë?

Tomi bën **detyrat.**

Era shpërndanë...

kë?

Era shpërndanë **gjethet.**

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin “**Fjalìa e thjeshtë dhe fjalìa e zgjeruar**”.

Veprimtaria e dytë - Punë e drejtuar / analizë

Analizohen fjalitë e krijuara nga nxënësit.

Babai punon.

Moraça është një lumë.

Genti lexon.

Futbollistët luajnë.

FJALI TË THJESHTA

Motra është **në shkollë.**

Taulanti dërgon **kartolinën.**

Tomi bën **detyrat.**

FJALI TË ZGJERUARA

Duke u bazuar në shembujt lart mësuesi shpjegon:

Fjalìa e thjeshtë ka kryefjalën dhe kallëzuesin.

Fjalìa e zgjeruar, përveç kryefjalës dhe kallëzuesit, ka dhe fjalë të tjera plotësuese.

Veprimtaria e tretë - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit lexojnë dhe komentojnë tekstin “Lumi Moraça” për të krijuar lidhjen logjike në mes të rrjedhjes së ujit dhe formimit të fjalive. Më pas analizojnë dhe diskutojnë me mësues-in/en shembujt e dhënë në tekst për fjalitë e thjeshta dhe të zgjeruara.

Veprimtaria e katërt - Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit qarkojnë përgjigjet e sakta.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit lexojnë fjalitë dhe bëjnë nga një vizatim për to.

Ushtrimi 3. Nxënësit në grupe krijojnë dy fjali të thjeshta dhe dy fjali të zgjeruara.

Shembull:

Vajza u zgjua.

Babai ujit lulet.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e pestë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe punojnë ushtrimet 1, 2, 4 dhe 7 sipas

kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit nënvizojnë fjalinë e thjeshtë në shembujt e dhënë. Pastaj e rishkruajnë atë.

Shembull:	<u>Vajza ujit</u> lulet e saksisë.	Vajza ujit.
	<u>Unë hëngra</u> një kek me arra.	Unë hëngra.
	<u>Muzikantët e qytetit erdhën.</u>	Muzikantët erdhën.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit fillimisht shkruajnë tri fjali të thjeshta. Më pas i kthejnë ato në të zgjeruara. Lexojnë fjalitë e krijuara.

Ushtrimi 4. Nxënësit në mënyrë individuale bashkojnë me shigjetë fjalët e mëposhtme dhe krijojnë fjali.

Shembull:

Marjani bleu një libër të ri.	Celulari im është prishur.
-------------------------------	----------------------------

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Ushtrimi 7. Në grupe nxënësit krijojnë një tekst mbi bazën e figurave. Në tekstin e krijuar nxënësit nënvizojnë me një vijë kryefjalën e me dy vija kallëzuesin. Në fund grupet ia japin librin njëri-tjetrit për ta lexuar dhe vlerësuar punën. Mësues-i/ja përcjell me vëmendje punën e nxënësve dhe jep sqarime, nëse është e nevojshme. Shpallet grupi fitues.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Veprimtaria e gjashtë - Punë në grupe

Nxënësit të ndarë në grupe punojnë ushtrimet e dhëna nga mësues-i/ja. Çdo grup punon ushtrime me kërkesa të ndryshme. Ushtrimet e nxënësve në grupe mësues-i/ja mund t'i prezantojë në projektor.

Gr.1 Krijojnë dy fjali të thjeshta dhe dy të zgjeruara mbi bazën e figurave.

Gr.2 Kthejnë fjalitë e thjeshta në të zgjeruara.

Gr.3 Kthejnë fjalitë e zgjeruara në të thjeshta.

Gr.4 Nënvizojnë me dy ngjyra të ndryshme fjalitë e thjeshta dhe të zgjeruara në tekstin e dhënë.

Në fund përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre. Mësues-i/ja përcjell me vëmendje prezantimet dhe nëse ka gabime, kërkon që ato të përmirësohen nga grupet e tjera. Shpallet grupi fitues mbi bazën e kriterëve të vendosura në fillim të punës.

.....
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 3, 5 dhe 6 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Fjalja dëftore, fjalja pyetëse, fjalja thirrmore

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë fjalitë dëftore, pyetëse dhe thirrmore dhe të sqarojë përse quhen ashtu;
- të shkruajë vetë fjali dëftore, pyetëse dhe thirrmore, duke respektuar shenjat e pikësimit.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimimit: vëzhgo - analizo, Di - Dua të di - Mësova, punë e drejtuar, harta e konceptit, lojë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri

Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë fjalitë dëftore, pyetëse dhe thirrmore;
- krijojnë fjali dëftore, pyetëse dhe thirrmore;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë tekstin dhe fjalitë e dhëna në tekstin mësimor;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: fjali dëftore, pyetëse, thirrmore etj.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurmes, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, etiketa me shenjat e pikësimit etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Vëzhgo - analizo

Nxënësit shikojnë me vëmendje fjalitë e shoqëruara me figura, të cilat mësuesi i ka paraqitur me projektor. Mësues-i/ja i lexon me intonacionin e duhur fjalitë dhe synon që nxënësit t'i dallojnë llojet e fjalive nga intonacioni dhe shenjat e pikësimit.

Nëna përgatiti gjellën.

A e përgatite gjellën nënë?

Ua, sa gjellë të shijshme ke përgatitur!

Pyetjet që u drejton mësuesi: A janë fjali të thjeshta apo të zgjeruara? Me çfarë fillojnë këto fjali? Me cilat shenja pikësimi mbarojnë?

Ç'është fjalja e parë? —————→ **Fjali me të cilën tregojmë** (synimi i mësuesit për këtë përgjigje).

Po fjalia e dytë?

Fjali me të cilën pyesim (synimi i mësuesit për këtë përgjigje).

Po e treta?

Fjali me të cilën shprehim habi (synimi i mësuesit për këtë përgjigje).

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja


Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Fjalia dëftore, fjalia pyetëse dhe fjalia thirrmore”**.

Veprimtaria e dytë: Di - Dua të di - Mësova

Nxënësit të nxitur nga pyetjet e mësuesit plotësojnë dy shtyllat e tabelës: DI - DUA TË DI. Shtylla MËSOVA plotësohet në fund të orës nga nxënësit.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Se fjalia përbëhet nga dy a më shumë fjalë që lidhen nga kuptimi. Se fjalia mund të jetë e thjeshtë ose e zgjeruar.	Çfarë është fjalia me të cilën tregojmë? Çfarë është fjalia me të cilën pyesim? Çfarë është fjalia me të cilën habitemi, shprehim kënaqësi etj? Cilat shenja pikësimi vendosim në fund të tyre?	

Duke u bazuar në shembujt lart mësues-i/ja shpjegon termat gjuhësorë për llojet e fjalive sipas kuptimit.



Fjalia me anë të cilës tregojmë quhet **fjali dëftore**. Në fund të fjalisë dëftore vendoset **pikë**.

Fjalia me anë të cilës pyesim për diçka quhet **fjali pyetëse**. Në fund të fjalisë pyetëse vendoset **pikëpyetje**.

Fjalia me anë të cilës shprehim gëzim (urim), habi, kënaqësi etj., quhet **fjali thirrmore**. Me anë të fjalisë thirrmore edhe mund të urojmë e përshëndesim. Në fund të saj vendoset **pikëçuditëse**.

Veprimtaria e tretë - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit lexojnë tekstin “Amari i përshkruan dhomën shokut të tij” dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna. Së bashku me mësues-in/en vendosin shenjat e pikësimi, që i ka harruar Amari.

Më pas analizojnë dhe diskutojnë me mësues-in/en shembujt e dhënë për fjalitë sipas kuptimit.

Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas

kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit vendosin **S** për përgjigjen e saktë dhe **G** për përgjigjen e gabuar.

Shembull:

a. Në fund të fjalisë dëftore vihet pikë. **S**

b. Fjalia, me anë të së cilës shprehim gëzim, habi, kënaqësi etj., quhet fjali pyetëse. **G**

Ushtrimi 3. Në mënyrë individuale, nxënësit shkruajnë nga një fjali për secilin lloj. Lexojnë fjalitë e krijuara.

Ushtrimi 4. Nxënësit në çifte krijojnë fjali pyetëse me grupet e fjalëve të dhëna.

Shembull:

Çfarë ke blerë në treg? Kur vjen treni nga Tivari? Sa libra ke lexuar?

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Veprimtaria e katërt - Punë në grupe

Nxënësit të ndarë në grupe formojnë fjali mbi bazën e shenjës së pikësimit. Çdo grup punon nga një shenjë pikësimi (? ! ose .). Detyra e grupeve është të krijojnë nga 4 fjali.

Gr.1 - PIKA

Gr.2 - PIKËPYETJA

Gr.3 - PIKËÇUDITËSJA

Në fund të punës përfaqësuesit e grupeve prezantojnë para klasës punën e grupeve të tyre, duke lexuar fjalitë e formuara.

Mësues-i/ja dëgjon punën e nxënësve në grupe dhe jep sqarime, nëse e sheh të nevojshme. Shpallet grupi fitues.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e pestë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 2, 3, 4 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit krijojnë fjali dëftore me grupet e fjalëve të dhëna.

Shembull:

Në pyll ka shumë kafshë.

Mimi po lexon një përrallë.

Ushtrimi 3. Në mënyrë individuale nxënësit lexojnë fjalitë dhe i vendosin në tabelë në shtyllën përkatëse.

Shembull:

1. Si shkoi dita sot? fjali pyetëse 2. Marrsh nota të mira! fjali thirrmore

Ushtrimi 4. Në mënyrë individuale nxënësit krijojnë fjali thirrmore me grupet e fjalëve të dhëna.

Shembull:

U bëfsh 100 vjeç!

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Ushtrimi 5. Në grupe nxënësit krijojnë katër fjali të ndryshme me temën e ditëlindjes.

Grupet prezantojnë punën e tyre. Nëse ka gabime, grupet korrigjojnë njëri-tjetrin.

Veprimtaria e gjashtë - Lojë/Garë

Tre nxënës ngrihen para tabelës dhe mbajnë në duar tri shenjat e pikësimit.

Nxënësit të ndarë në grupe formojnë fjali të ndryshme brenda 5 minutash. Në fund grupet

lexojnë fjalitë e krijuara. Shpallet fitues grupi që ka krijuar më shumë dhe saktë fjali të ndryshme.

.....
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 nga fletorja e punës. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Mësojmë shenja të tjera të pikësimit

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të përdorë drejt pikën, pikëpyetjen, pikëçuditjen në fund të fjalisë, si dhe dy pikat e presjen gjatë numërimit.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimi: kubimi, punë e drejtuar, rrjeta e merimangës, shpjegim, harta e konceptit, lojë e shenjave të pikësimit etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- formojnë fjali duke bërë garë me teknikën kubimi;
- dallojnë përdorimin në të lexuar dhe shkruar të shenjave të pikësimit;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë tekstin dhe fjalitë e dhënë në tekstin mësimor;
- mësojnë dhe argëtohen përmes rrjetës së merimangës;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

.....
Fjalët kyçe: shenja pikësimi, pikë, pikëpyetje, pikëçuditje, dy pikat, presja.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, kuba, karton me shenja pikësimi, fisha me fjali, rrotë peni etj.

.....
ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - kubimi

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit vendosen në tri kolona dhe fitojnë nga një kub, në faqet e të cilit janë ngjitur tri shenjat e pikësimit (. ? !). Detyra e nxënësve është që të hedhin kubin dhe të formojnë fjali me shenjën e pikësimit, që u del. Nxënësit që gabojnë ulen në banka dhe mendojnë të rregullojnë gabimin. Shpallet fitues grupi i nxënësve, që ka formuar më shumë dhe saktë fjali. Mësues-i/ja gjatë kësaj loje këmbëngul që nxënësit të shqiptojnë me intonacionin e duhur fjalitë.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimi dhe shkruan në tabelë titullin “**Shenjat e pikësimit**”.

Veprimtaria e dytë – Punë e drejtuar

Nxënësit lexojnë me vëmendje fjalitë, të cilat mësues-i/ja i ka paraqitur në projektor/tv dhe vëzhgojnë shenjat e pikësimit të vendosura në këto fjali me ngjyrë të kuqe.


Ardita është fshehur prapa gardhit.

Çfarë gjuhe flet Alma?

Rrugë të mbarë Sokol!

Në teatrin e kukullave shkuan: Ana, Qamili, Iliri dhe Albani.

Nxënësit së bashku me mësues-in/en plotësojnë hartën e koncepteve. Mësues-i/ja shpjegon rregullat në të shkruar dhe të lexuar për çdo shenjë pikësimit duke i konkretizuar me shembuj.



Veprimtaria e tretë - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit lexojnë tekstin “Niagara shqiptare” dhe vërejnë përdorimin e shenjave të pikësimit. Mësues-i/ja vë theksin te përdorimi i dy pikave dhe presjes.

Më pas kalohet në leximin e rregullave gjuhësore për përdorimin e shenjave të pikësimit.

Veprimtaria e katërt - Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale vendosin shenjë të pikësimit në fund të fjalive.

Shembull: Dea bleu: fruta, perime, ëmbëlsira.

Hajde shpejt!

Dimri është stinë e ftohtë.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit krijojnë nga një fjalë me fotot e dhëna.

Ushtrimi 3. Në çifte nxënësit ngjyrosin shenjë të pikësimit.

Shembull: A luajmë bashkë? Kthehu shpejt këtu!

Ushtrimi 4. Nxënësit në çifte nënvizojnë me ngjyrë të kuqe kryefjalën dhe me ngjyrë blu kallëzuesin.

Shembull:

Fletorja ka detyrat e mia.

Ai rrëshqiti në tokë.

fletorja → kryefjala ka → kallëzuesi

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Veprimtaria e pestë - Loja e shenjave të pikësimit/Punë në grupe

Nxënësit të ndarë në grupe fitojnë nga një zarf me fjalë të ndryshme të shkruara në fisha. Detyra e grupeve është të lexojnë fjalitë dhe të vendosin kartonat me shenjat e duhura të pikësimit. Në fund grupet prezantojnë dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. Mësues-i/ja përcjell me kujdes vlerësimin që grupet i bëjnë njëri-tjetrit. Shpallet grupi fitues.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e gjashtë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 2, 3, 4 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit shënojnë me X fjalitë në të cilat shenjat e pikësimit janë vendosur gabim.

Shembull:

Po bëj detyrat e shtëpisë! X

Kush e fitoi ndeshjen! X

Ushtrimi 3. Në mënyrë individuale nxënësit zgjerojnë fjalinë duke iu përgjigjur pyetjeve.

Shembull: Tomi mëson në tokë.

Tomi mëson në tokë me Anën.

Pasditë Tomi mëson në tokë me Anën.

Ushtrimi 4. Në grupe nxënësit vendosin në tekst shenjat e pikësimit që duhen. Disa nxënës lexojnë tekstin dhe mësuesi vëren nëse nxënësit i respektojnë rregullat gjuhësore për shenjat e pikësimit.

Ushtrimi 5. Në grupe nxënësit nënvizojnë fjalinë e thjeshtë në fjalitë e dhëna. E rishkruajnë atë.

Shembull: Macja u afrua. Plazhi ishte mbushur.

Grupet prezantojnë punën e tyre. Nëse ka gabime, grupet korrigjojnë njëri-tjetrin.

Veprimtaria e shtatë - Rrjeta e merimangës

Vendosen nxënësit në rreth. Njëri nxënës mban lëmshin e perit në dorë. Mendon shenjën e pikësimit dhe ia hedh lëmshin shokut, që dëshiron të përgjigjet (të krijojë fjali me atë shenjë pikësimi). Kështu veprohet me të gjithë nxënësit.

.....

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 1, 6 dhe 7 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Mësojmë fjalët që tregojnë njerëz, kafshë, sende ose vende

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë emrin si fjalë që tregon njerëz, kafshë, sende e vende në numrin njëjës e shumës;

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimin: lexim i drejtuar, kubimi, punë e drejtuar, rrjeta e merimangës, pyetja sjell pyetjen etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë emrin, si fjalë që tregon njerëz, kafshë, sende ose vende;
- gjejnë sa më shumë emra duke bërë garë me teknikën e kubimit;
- krijojnë fjali duke përdorur emra të ndryshëm;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë tekstin e dhënë në tekstin mësimor;
- mësojnë dhe argëtohen përmes rrjetës së merimangës;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit;
- dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë.

.....
Fjalët kyçe: emër, njerëz, kafshë, sende, vende.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, kuba, lësh peni etj.

.....
ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë: Lexim i drejtuar/ Pyetja sjell pyetjen

Ora e mësimin fillon me këtë veprimtari: Mësues-i/ja paraqet në projektor/tv tekstin "Një ditë në park". Fton nxënësit ta lexojnë në heshtje tekstin dhe tërheq vëmendjen e tyre te fjalët me ngjyrë të zezë.

Një ditë në park

Një ditë të bukur **fëmijët** po luanin në **park**. **Mami** i shikonte nga larg dhe kujdesej për **fëmijën** e vogël. **Fëmijët** shijonin ajrin e freskët dhe diellin që shkëlqente. Dikush kishte hipur në **pemë**, dikush tundej në **lëkundës**, një **vajzë** luante me **litar**, dy të tjerë kishin marrë një **top**. Mes **fëmijëve**, **qeni** besnik rrinte duke i parë.

– Çfarë tregojnë fjalët me ngjyrë të zezë?

Shembull:

fëmijët → **tregon njeri** (synimi i mësues-it/es për këtë përgjigje)

qeni → **tregon kafshë** (synimi i mësues-it/es për këtë përgjigje)

lëkundës → **tregon send** (synimi i mësues-it/es për këtë përgjigje)

park → **tregon vend** (synimi i mësues-it/es për këtë përgjigje)

– A dini fjalë tjera që tregojnë njerëz, kafshë, sende apo vende? Jepen shembuj të tjerë nga nxënësit.

U bëhet e qartë nxënësve, se emra janë edhe fjalët që tregojnë njerëz që ushtrojnë një profesion të caktuar, si p. sh.: mësuese, dentist, inxhinier, mjeke, pilot etj.

– Si i quajmë fjalët që tregojnë njerëz, kafshë, sende dhe vende? Synohet që përmes bisedës me nxënës të arrihet te përkufizimi i emrit.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin “**Mësojmë fjalët që tregojnë njerëz, kafshë, sende ose vende**”.

Veprimtaria e dytë – Punë e drejtuar / Punë në tekstin mësimor

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes ilustrimin e dhënë në tekstin mësimor dhe lidhin me shigjetë fjalët me figurat. Më pas plotësojnë tabelën.

njerëz	kafshë	sende	vende
fëmijë	qen	lëkundës	park

Lexohet rregulla gjuhësore për emrin.

Emrat janë fjalë që tregojnë njerëz, kafshë, sende ose vende.

Veprimtaria e tretë - Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale nënvizojnë emrat në tekstin “Një ditë në park”.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit vendosin emrat e dhëna në tabelë, në shtyllën e duhur.

emra që tregojnë njerëz	emra që tregojnë kafshë	emra që tregojnë sende	emra që tregojnë vende
djalë	lopë	laps	kodër

Ushtrimi 3. Nxënësit në çifte krijojnë fjali me nga një emër prej secilit grup.

Shembull:

Ai është djalë i sjellshëm. Gjyshja kujdeset për lopët në fshat.

Ushtrimi 4. Në mënyrë individuale nxënësit renditin objektet që ndodhen në çantë.

Shembull: libër, fletore, vizore, gërshërë etj.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Veprimtaria e katërt - Kubimi

Nxënësit vendosen në tri kolona dhe fitojnë nga një kub, në katër faqet e të cilit janë shkruar fjalët: njerëz, kafshë, sende dhe vende. Detyra e nxënësve është që të hedhin kubin dhe të gjejnë emra sipas fjalës, që u del në faqen e kubit. Shpallet fitues grupi i nxënësve, që ka gjetur më shumë emra. Mësues-i/ja përcjell me vëmendje lojën dhe ndërhyr, kur e sheh të nevojshme.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e pestë – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 3, 4 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 3. Në mënyrë individuale nxënësit zgjidhin fjalëkryqin.

1. zebra 2. lule 3. libër 4. makinë

Ushtrimi 4. Në çifte nxënësit plotësojnë fjalitë me emrat e vendosur në zemër. Lexohet teksti nga dy nxënës.

Ushtrimi 5. Në grupe nxënësit krijojnë një tekst sipas ilustrimit duke përdorur emra të ndryshëm.

Grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Veprimtaria e gjashtë - Rrjeta e merimangës

Vendosen nxënësit në rreth. Njëri nxënës mban lëmshin e perit në dorë. Mendon një emër dhe ia hedh lëmshin shokut, që dëshiron të përgjigjet (se çfarë emri është ai që ka thënë shoku). Kështu veprohet me të gjithë nxënësit.

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën “Mos e dëmto natyrën”. Tregojnë emrat që kanë mbajtur mend nga kënga.

.....
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 dhe 2 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të klasifikojë emrat në të përgjithshëm dhe të përveçëm, në gjininë mashkullore e femërore;
- të përdorë drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe tek emrat e përveçëm;

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: kllaster, lexim i drejtuar, pyetja sjell pyetjen, alfabeti i njëpasnjëshëm etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm në fjali dhe tekste;
- punojnë me teknikën kllaster dhe alfabetin e njëpasnjëshëm;
- krijojnë fjali duke përdorur emra të ndryshëm;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë tekstin e dhënë në tekstin mësimor;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit;
- dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë.

.....
Fjalët kyçe: emri, emra të përgjithshëm, emra të përveçëm, shkronja e madhe


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, tv, cd, mjete vizatimi, grafiku “Alfabeti i njëpasnjëshëm”. etj.

.....
ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Kllaster

Nxënësit njohuritë e fituara për emrin i tregojnë duke plotësuar skemën e Kllasterit. Mësues-i/ja u tërheq vëmendjen nxënësve tek emrat e njerëzve, kafshëve, sendeve dhe vendeve.



- Emrat e cilave grupe mund t'i ndajmë në dy grupe të tjera? Njerëz, kafshë, sende, vende
- Mbi bazën e cilës karakteristikë mund t'i ndajmë? Plotësohet tabela edhe me emra të tjerë nga nxënësit.

Emra të shkruar me shkronjë të vogël	Emra të shkruar me shkronjë të madhe
babai, mjeku, dele, macja	Liria, Balo, Guci, Barbi
top, batanije, fshat, mal	

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm”**.

Veprimtaria e dytë - Lexim i drejtuar / Pyetja sjell pyetjen

Nxënësit lexojnë tekstin “Qenushi Pugi” dhe mësues-i/ja tërheq vëmendjen e tyre te fjalët e shkruara me ngjyrë të kuqe dhe të kaltër.

- Çfarë janë fjalët e shënuara me ngjyrë të kuqe dhe të kaltër? Pse janë shënuar me dy ngjyra? Me çfarë shkronje janë shënuar? etj.

Duke u bazuar në analizën e tekstit “Qenushi Pugi” dhe shembujt më lart mësues-i/ja shpjegon rregullën gjuhësore për emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm. Po ashtu shpjegon përmes shembujve konkretë përdorimin e shkronjës së madhe.

Veprimtaria e tretë - Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në çifte gjejnë emrat e tjerë të përgjithshëm dhe të përveçëm në tekstin mësimor dhe i shënojnë me ngjyrat përkatëse.

Shembull:

Emra të përveçëm Pugi, Cem etj

Emra të përgjithshëm mami, shtëpi etj.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit u vendosin nga një emër të përveçëm figurave.

Shembull: macja Kiti qeni Balo

Ushtrimi 3. Në mënyrë individuale nxënësit ngjyrosin vetëm emrat e përgjithshëm, pastaj i vendosin ata në tabelë aty ku u takon.

Ushtrimi 4. Në çifte nxënësit shënojnë me \surd fjalët e shkruara saktë. Argumentojnë përgjigjen e tyre.

Shembull: Deçiçi Ulqini Leoni nxënës lojë

Veprimtaria e katërt - Alfabeti i njëpasnjëshëm

Nxënësit të ndarë në 4 grupe fitojnë grafikun me alfabetin e njëpasnjëshëm. Detyra e grupeve është që për çdo shkronjë të alfabetit të shkruajnë një emër të përveçëm njeriu, kafshe, sendi ose vendi.

Gr.1	A	B	C	Ç	D	Dh	E	Ë	F
	Ana	Bratica	Cem	Çufo	Dedaj	Dhurata	Ela	Ënda	Fatjoni
	G	Gj	H	I	J	K	L	Ll	M
	Grudë	Gjokë	Hot	Illir	Jetmir	Kraja	Laruka	Lleshi	Martinaj
	N	Nj	O	P	Q	R	Rr	S	Sh
	Nreka	Njëbrirëshi	Ostros	Plluncaj	Quko	Reçi	Rroku	Sukobina	Shasi
	T	Th	U	V	X	Xh	Y	Z	Zh
	Tivari	Thtjani	Ulqini	Vuthaj	Xemo	Xheki	Ylli	Zogaj	Zheni

Në fund secili grup prezanton punën para klasës sipas shkronjave që ka pasur.

Mësues-i/ja i shkruan në grafikun e zmadhuar të vendosur para klase. Vlerësohet puna e nxënësve.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e pestë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 4, 5, 6, 7 dhe 8 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 4. Në mënyrë individuale nxënësit qarkojnë mënyrën e saktë të shkrimit të emrit mace.

Shembull:

Macja po kërkon ushqim.

E zuri gjumi macen.

Ushtrimi 5. Në çifte nxënësit nënvizojnë me ngjyrë blu emrat e përgjithshëm dhe me ngjyrë të kuqe emrat e përveçëm

Shembull:

Një pulëbardhë fluturoi mbi detin Adriatik.

Lumi Buna ka lloje të ndryshme peshqish.

Ushtrimi 6. Në çifte nxënësit plotësojnë fjalitë.

Shembull:

Notari noton në pishinë.

Zjarrfikësi shuan zjarrin.

Alpinisti ngjiti malin.

Mjeku vizitoi djalin.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Ushtrimet 7 dhe 8 punohen nga nxënësit në grupe. Në fund grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë “Vendi im”.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 1, 2 dhe 3 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Gjinia e emrit

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të klasifikojë emrat në të përgjithshëm dhe të përveçëm, në gjininë mashkullore e femërore.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: analizë, vëzhgo – diskuto, gu-shëkuqi rrethor, punë e drejtuar, loja “Lëviz, ndalo, krijo dyshe” etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë emrat e gjinisë mashkullore nga ato femërore;
- krijojnë fjali duke përdorur emra të ndryshëm;
- shkruajnë qartë e saktë duke zbatuar rregullat gjuhësore;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri - tjetrit;
- dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë.

.....
Fjalët kyçe: gjini, gjini mashkullore, gjini femërore

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, cd, mjete vizatimi, fletë A4 etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Analizë

Nxënësit në fjalitë e mëposhtme nënvizojnë emrat dhe përcaktojnë llojin e tyre.

- a) Babai im pa në mal një ari të madh.
- b) Djali shkoi në shkollë me gëzim.
- c) Agroni u zgjua në orën 7.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin “**Gjinia e emrit**”.

Veprimtaria e dytë: vëzhgo - diskuto

Nxënësit emërtojnë figurat e paraqitura në projektor nga mësues-i/ja.



– Me çfarë mbarojnë këta emra? Plotësohet tabela nga përgjigjet e nxënësve.

Emra që mbarojnë me - i	Emra që mbarojnë me - u	Emra që mbarojnë me - a	Emra që mbarojnë me - ja
djali, luani	ariu	ora, vajza	mësuesja, anija

Mësues-i/ja shpjegon rregullën gjuhësore

Emrat e gjinisë mashkullore mbarojnë me **-i, -u**.
 Emrat e gjinisë femërore mbarojnë me **-a, -ja**.
 Emri ka dy gjini: **gjininë mashkullore** dhe **femërore**.

Veprimtaria e tretë - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe analizojnë tekstin “Keku me mollë”. Më pas nxënësit lexojnë dhe analizojnë edhe shembujt e tjerë.

Punimi i ushtrimeve në tekst

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale vendosin në tabelë emrat e gjinisë mashkullore dhe ato të gjinisë femërore. Qarkojnë me çfarë mbarojnë secili prej tyre.

Shembull:

Emra të gjinisë mashkullore: gjyshi, telefoni, zogu, lumi, miu.

Emra të gjinisë femërore: kukulla, bretkosë, piktura, gjethja, delja.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit nënvizojnë me ngjyrë të kuqe emrat e gjinisë mashkullore dhe me ngjyrë të gjelbër emrat e gjinisë femërore.

Shembull:

Macja e Zanës quhet Bardhoshe. Emrat janë në gjininë femërore.

Gjyshi i ka mësuar Albanit shumë histori interesante. Emrat janë në gjininë mashkullore.

Veprimtaria e katërt – punë në grupe/ Gushëkuqi rrethor

Nxënësit të ndarë në 4 grupe punojnë detyrat e dhëna nga mësues-i/ja në një fletë. Fleta paloset në formë fizarmonike dhe pasohet nga njëri nxënës tek tjetri.

Grupi I shkruajnë emra në gjininë femërore që mbarojnë me – a.

Grupi II shkruajnë emra në gjininë femërore që mbarojnë me – ja.

Grupi III shkruajnë emra në gjininë mashkullore që mbarojnë me – i.

Grupi IV shkruajnë emra në gjininë mashkullore që mbarojnë me – u.

Në fund përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre. Shpallet fitues grupi i nxënësve, që ka gjetur më shumë emra.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e pestë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 1, 2, 4 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit gjejnë gjininë femërore të emrave të dhënë.

Shembull:

mjek – mjeke mësues – mësuese dentist - dentiste

shok – shoqe polic – police maçok – mace

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit krijojnë fjali me dy emra të gjinisë mashkullore dhe dy emra të gjinisë femërore. Lexohen disa fjali të krijuara.

Shembull:

Dentistja i mjekoi dhëmbin.

Ky mësues është i aftë.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Ushtrimet 4 dhe 5 punohen nga nxënësit në grupe. Grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Veprimtaria e gjashtë: Loja "Lëviz, ndalo, krijo dyshe"

Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe, kur mësuesi përplas duart, ata ndalojnë dhe formojnë çifte me shokun që kanë pranë.

Shembull:

Nx. 1- thotë një emër në gjininë mashkullore

Nx. 2- thotë emrin përkatës në gjininë femërore

djalë

vajzë

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën "Mik me librin". Tregojnë emrat që kanë mbajtur mend nga kënga. Mund t'i klasifikojnë sipas gjinisë.

.....
Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Numri i emrit

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë emrin si fjalë që tregon njerëz, kafshë, sende e vende në numrin njëjës e shumës;
- të klasifikojë emrat në të përgjithshëm dhe të përveçëm, në gjininë mashkullore e femërore.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: kllaster, vëzhgo – diskuto, gu-shëkuqi rrethor, punë e drejtuar, rrjeta e merimangës, shkrim i lirë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë emrat në numrin njëjës e shumës;
- dallojnë emrat e gjinisë mashkullore nga ato femërore;
- krijojnë fjali e tekste duke përdorur emra të ndryshëm;
- shkruajnë qartë e saktë duke zbatuar rregullat gjuhësore;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

.....
Fjalët kyçe: numri, numri njëjës, numri shumës


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurtesë, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, fletë A4 etj.

.....
ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - kllaster

Nxënësit njohuritë e fituara për emrin i tregojnë duke plotësuar skemën e kllasterit.



Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin “Numri i emrit”.

Veprimtaria e dytë: vëzhgo - diskuto

Nxënësit shikojnë me kujdes ilustrimet e paraqitura në projektor dhe plotësojnë së bashku me mësues-in/en tabelën.



(një) makinë



(disa) makina



flutura



fluturat

Numri njëjës	Numri shumës
(një) makinë 	(disa) makina 
flutura 	fluturat 

Mësues-i/ja shpjegon rregullën gjuhësore

Emri ka dy numra: **njëjës** dhe **shumës**.

Emrat janë në numrin njëjës kur tregojnë një person, një kafshë, një send ose një vend.

Emrat janë në numrin shumës kur tregojnë dy ose më shumë persona, kafshë, sende ose vende.

Veprimtaria e tretë – Punë në tekstin mësimor

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe analizojnë shembujt e dhënë në tekst.

Punimi i ushtrimeve në tekst

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit shënojnë me **Nj** emrat që janë në numrin njëjës

dhe me **Sh** ato në numrin shumë.

Shembull:

male

Sh

pyll

Nj

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit kthejnë në numrin shumë emrat e dhënë.

Shembull:

lis – lisa

pallat – pallate

qytet – qytete

Veprimtaria e katërt – punë në grupe/ Gushëkuqi rrethor

Nxënësit të ndarë në 4 grupe punojnë detyrat e dhëna nga mësues-i/ja në një fletë. Fleta paloset në formë fizarmonike dhe pasohet nga njëri nxënës tek tjetri.

Grupi I shkruajnë emra në numrin njëjës.

Grupi II shkruajnë emra në numrin shumë.

Grupi III shkruajnë emra në numrin njëjës.

Grupi IV shkruajnë emra në numrin shumë.

Në fund përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre. Shpallet fitues grupi i nxënësve që ka punuar pa gabime.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e pestë – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 1, 3 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit rrethojnë formën e saktë të emrit në fjalitë e dhëna.

Shembull:

Frutat janë të shëndetshme.

Janë shokë të mirë.

Ushtrimi 3. Në çifte nxënësit plotësojnë tabelën, sipas modelit të dhënë.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Ushtrimi 5. punohen nga nxënësit në grupe. Grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Veprimtaria e gjashtë – Rrjeta e merimangës

Vendosen nxënësit në rreth. Njëri nxënës mban lëmshin e perit në dorë. Mendon një emër dhe ia hedh lëmshin shokut, që dëshiron të përgjigjet (në cilin numër është emri që ka thënë shoku). Kështu veprohet me të gjithë nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 2 dhe 4 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Fjalët që tregojnë cilësi

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë mbiemrin si fjalë që tregon cilësinë e emrit.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mëimit: Vëzhgo - diskuto, lexim i drejtuar, pyetja sjell pyetjen etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë mbiemrin si fjalë që tregon cilësinë e emrit;
- identifikojnë mbiemrat në fjali, tekst dhe këngë;
- krijojnë fjali e tekste duke përdorur mbiemra të ndryshëm;
- shkruajnë qartë e saktë duke zbatuar rregullat gjuhësore;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- lexojnë me kujdes dhe analizojnë tekstin e dhënë në tekstin mësimor;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri - tjetrit.

Fjalët kyçe: fjalë që tregojnë cilësi, mbiemri


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, projektor/tv, kompjuter, tv, cd, mjete vizatimi, fletë A4 etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë: Vëzhgo – diskuto

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurat e paraqitura në projektor/tv dhe tregojnë cilësitë kryesore të secilës.



– Çfarë na tregojnë këto fjalë? Si janë njerëzit, kafshët, sendet dhe vendet. Nxënësit së bashku me mësuesin, duke analizuar shembujt më lart, arrijnë të rregulla gjuhësore:

Mbiemrat janë fjalë që tregojnë se si janë njerëzit, kafshët, sendet, vendet etj. Ata tregojnë cilësinë e tyre.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Fjalët që tregojnë cilësi”**.

Veprimtaria e dytë – Lexim i drejtuar / Pyetja sjell pyetjen

Nxënësit lexojnë tekstin “Shoku im Dritoni” dhe mësues-i/ja tërheq vëmendjen e tyre te fjalët e shkruara me ngjyrë të kuqe dhe të gjelbër.

– Çfarë janë fjalët e shënuara me ngjyrë të kuqe dhe të gjelbër? Si është Dritoni? A ka mbiemra të tjerë në këtë tekst? etj.

Më pas analizohen shembujt e tjerë të dhënë në tekst (lule e kuqe, mësuese e dashur etj.).

Veprimtaria e tretë – Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimit

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimit.

Ushtrimi 1. Nxënësit në çifte nënvizojnë të gjithë mbiemrat në tekstin “Shoku im Dritoni”.

Shembull: i mirë, i sigurtë, i dashur, i gatshëm etj.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit në togjet e dhëna nënvizojnë mbiemrat dhe plotësojnë tabelën.

Shembull: mësues i rreptë mace e bardhë

Ushtrimet 3 dhe 4 nxënësit i punojnë në grupe. Në fund secili grup prezanton punën para klasës.

Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e katërt – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 1, 2, 5 dhe 6 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Në mënyrë individuale nxënësit shkruajnë nga një emër për mbiemrat e dhënë.

Shembull:

këmishë e bardhë rrugë e gjatë liqen i thellë

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit krijojnë katër fjali me katër togjet e formuara.

Shembull:

Sa të kushtoi këmisha e bardhë? Ajo ishte rrugë e gjatë.

Ushtrimi 5. Në mënyrë individuale nxënësit krijojnë katër fjali me mbiemrat: i shkurtër, i gëzuar, i kaltër, frikacak.

Shembull: Ky rrip është i shkurtër. Babai ishte i gëzuar.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Ushtrimi 6 punohen nga nxënësit në grupe. Në fund grupet prezantojnë punën e tyre.

Shpallet fitues grupi që ka përshkruar klasën duke përdorur më shumë mbiemra dhe ka pak ose aspak gabime drejtshkrimore.

Veprimtaria e pestë – Punë në çifte

Nxënësit dëgjojnë këngën për fëmijë “Kam një mace topolake” dhe shkruajnë mbiemrat që kanë mbajtur mend. Në fund çiftet prezantojnë punën e tyre. Shpallet fitues çifti që ka shkruar më shumë mbiemra.

.....

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 3 dhe 4 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Mbiemrat e nyjshëm dhe mbiemrat e panyjshëm

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të klasifikojë mbiemrat në të nyjshëm dhe të panyjshëm;
- të shkruajë drejt mbiemrat që mbarojnë me: **-ë, -ët, -të.**

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mëimit: gushëkuqi rrethor, lexim i drejtuar, Di – dua të di – mësova, rrjeta e merimangës etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm në fjali dhe tekste;
- mësojnë dhe argëtohen përmes teknikave rrjeta e merimangës dhe kubimi;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

.....
Fjalët kyçe: mbiemër, mbiemër i nyjshëm, mbiemër i panyjshëm.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurmes, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, fletë A4 etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë – Gushëkuqi rrethor / Punë në grupe

Nxënësit të ndarë në grupe shkruajnë mbiemra në një fletë të bardhë. Fleta paloset në formë fizarmonike dhe pasohet nga njëri nxënës te tjetri. Në fund grupet prezantojnë para klasës punën e tyre. Nëse ka gabime, grupet korrigjojnë njëri-tjetrin.

Mbiemrat e shkruar nga nxënësit mësues-i/ja i shkruan në një tabak letre, duke i veçuar me ngjyra të ndryshme:

- a) mbiemrat e nyjshëm me ngjyrë të kaltër
- b) mbiemrat e panyjshëm me ngjyrë të kuqe.

Çfarë mendoni, pse i kam shkruar me ngjyra të ndryshme mbiemrat? Nga se dallohen?

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mëimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm”**.

Veprimtaria e dytë – Di - dua të di – mësova.

Nxënësit të nxitur nga pyetjet e mësuesit plotësojnë dy shtyllat e tabelës: DI - DUA TË DI. Shtylla MËSOVA plotësohet në fund të orës nga nxënësit.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Mbiemrat janë fjalë që tregojnë cilësinë e emrave.	Sa llojesh janë mbiemrat? Nga se dallohen ata?	

Nxënësit së bashku me mësues-in/en klasifikojnë mbiemrat e mësipërm në mbiemra të nyjshëm dhe mbiemra të panyjshëm.

Shembull:

Mbiemra të nyjshëm	Mbiemra të panyjshëm
i hollë	frikacak
i lartë	besnik
e bukur	faqekuqe
e pastër	zemërgjerë
e ëmbël	kaçurrel
i gjatë	shembullor

Duke u bazuar në shembujt lart mësues-i/ja shpjegon termat gjuhësorë për llojet e mbiemrave.

Mbiemrat në gjuhën shqipe janë dy llojesh: **mbiemra të nyjshëm** dhe **mbiemra të panyjshëm**. Mbiemrat që kanë një nyjë përpara quhen **mbiemra të nyjshëm**. Mbiemrat që nuk kanë nyjë, quhen **mbiemra të panyjshëm**.

Veprimtaria e tretë – Punë në tekstin mësimor/Punë e drejtuar

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe analizojnë shembujt e dhënë në tekstin mësimor. Lexohet rregulla gjuhësore dhe tërhiqet vëmendja e nxënësve te mbiemrat që mbarojnë me **-ë, -ët, - të**.

i çalë, i hollë, i gjallë, i mirë etj.
i dobët, i cekët, i athët etj.
i gjatë, i artë, i ngurtë, i pestë etj.

Veprimtaria e katërt - Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale i vendosin në tabelë mbiemrat nga teksti "Shoku im Dritoni".


Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit emrave të dhënë u shtojnë nga një mbiemër.

Shembull:

Emër + mbiemër i nyjshëm	Emër + mbiemër i panyjshëm
vajzë e gjatë	vajzë punëtore
djalë i sjellshëm	djalë besnik

Ushtrimi 3. Në mënyrë individuale nxënësit lidhin me shigjetë sipas modelit.

Shembull:



Ushtrimi 4. Në çifte nxënësit krijojnë katër fjali me grupet e formuara.

Shembull: Ai është mësues i aftë.

Veprimtaria e pestë – Rrjeta e merimangës

Vendosen nxënësit në rreth. Njëri nxënës mban lëmshin e perit në dorë. Mendon një mbiemër dhe ia hedh lëmshin shokut, që dëshiron të përgjigjet (se çfarë mbiemri është ai që ka thënë shoku). Kështu vepohet me të gjithë nxënësit.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e pestë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 2, 3, 4 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit shkruajnë nga dy ose tre mbiemra për secilin emër të dhënë në figurë.

Shembull:

ëmbëlsirë - e shijshme, e ëmbël, e bukur;

limon – i thartë, i verdhë.

Ushtrimi 3. Në çifte nxënësit qarkojnë formën e saktë të mbiemrit.

Shembull:

mur i gurtë vajza e hollë

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Ushtrimet 4 dhe 5 nxënësit i punojnë në grupe. Në fund grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Veprimtaria e gjashtë – Kubimi

Nxënësit vendosen në tri kolona dhe fitojnë nga një kub, në faqet e të cilit janë shkruar fjalët: **i nyjshëm, i panyjshëm**. Detyra e nxënësve është që të hedhin kubin dhe të thonë mbiemrin, që u del (i nyjshëm, i panyjshëm). Nxënësit që gabojnë ulen në banka dhe mendojnë të rregullojnë gabimin. Shpallet fitues grupi i nxënësve, që ka gjetur më shumë mbiemra.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 dhe 6 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Gjinia e mbiemrit

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë gjininë e mbiemrit.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: Kllaster, gushëkuqi rrethor, punë e drejtuar, Diagrami i Venit, loja "Lëviz, ndalo, krijo dyshe" etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë mbiemrat e gjinisë mashkullore nga mbiemrat e gjinisë femërore;
- përshtasin mbiemrin me emrin dhe të kundërtën;
- mësojnë dhe argëtohen përmes teknikave gushkuqi rrethor dhe lojës "Lëviz, ndalo, krijo dyshe";
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: mbiemër, gjinia mashkullore, gjinia femërore.


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, fletë A4 etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Kllaster

Nxënësit njohuritë e fituara për mbiemrin i tregojnë duke plotësuar skemën e Kllasterit.



Veprimtaria e dytë - Gushëkuqi rrethor

Nxënësit të ndarë në katër grupe kryejnë detyrat e dhëna nga mësuesi.

Gr.I Shkruajnë emra në gjininë mashkullore.

Gr.II Shkruajnë emra në gjininë femërore.

Gr.III Shkruajnë emra në gjininë mashkullore.

Gr.IV Shkruajnë emra në gjininë femërore.

Fleta paloset në formë fizarmonike dhe kalohet nga njëri nxënës tek tjetri. Nxënësit prezantojnë punën e bërë në grupe. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Gjinia e mbiemrit”**.

Veprimtaria e tretë – Punë e drejtuar

Mësues-i/ja paraqet me projektor foto të shoqëruara me grupe emërore:



djalë i vogël



vajzë e vogël

U drejton nxënësve pyetjet:

- Çfarë janë fjalët me ngjyrë të zezë? Po fjalët me ngjyrë të kuqe? Në ç’gjini janë emrat djali dhe vajza? Si mendoni, në ç’gjini do të jenë mbiemrat që u vijnë pas?

Mësues-i/ja shpjegon rregullën gjuhësore:

Mbiemri, ashtu si emri ka **gjininë mashkullore** dhe **gjininë femërore**.
Mbiemri vendoset në atë gjini që është edhe emri, tiparin e të cilit tregon.

Veprimtaria e katërt – Punë në tekstin mësimor/Punë e drejtuar

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe analizojnë shembujt e dhënë në tekstin mësimor. Punohet rubrika **Pyetje**.

Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale punojnë sipas këtij modeli.

Shembull:

lumë i gjatë – dorë e gjatë

zog i bukur – shkollë e bukur.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit krijojnë dy fjali me dy nga grupet emërore të ushtrimit 1.

Ushtrimin 3 nxënësit e punojnë në grupe. Mbas përfundimit të punës grupet prezantojnë punën e tyre. Grupet korrigjojnë dhe vlerësojnë punën e njëri - tjetrit.

Veprimtaria e pestë – Loja “Lëviz, ndalo, krijo dyshe”.

Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe kur mësues-i/ja përplas duart, ata ndalojnë dhe formojnë çifte me shokun që kanë pranë.

Nx. 1- thotë një mbiemër në gj. mashkullore Nx. 2- thotë mbiemrin përkatës në gj. femërore
i madh, e madhe.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e gjashtë – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në grupe punojnë ushtrimet 2, 3 dhe 4 sipas kërkesave

nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Në mënyrë individuale nxënësit emrat e dhënë i shoqërojnë me nga një mbiemër.

Shembull: libër i vjetër kukull e bukur.

Ushtrimet 3 dhe 4 punohen nga nxënësit në grupe. Mbas përfundimit të punës grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë nga nxënësit në grupe.

Veprimtaria e shtatë - Diagrami i Venit

Nxënësit në çifte krahasojnë nga dy mbiemra.



Shembull:

i mirë

syzezë

e bukur

besnik



Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Numri i mbiemrit

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë gjininë dhe numrin e mbiemrit.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mëimit: Kllaster, gushëkuqi rrethor, punë e drejtuar, Diagrami i Venit, loja "Lëviz, ndalo, krijo dyshe" etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë mbiemrat e gjinisë mashkullore nga mbiemrat e gjinisë femërore;
- dallojnë numrin e mbiemrit;
- përshtasin mbiemrin me emrin dhe të kundërtën;
- mësojnë dhe argëtohen përmes teknikave gushkuqi rrethor dhe lojës "Lëviz, ndalo, krijo dyshe";
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: mbiemër, numri njëjës, numri shumës, gjinia mashkullore, gjinia femërore


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, fletë A4 etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Kllaster

Nxënësit njohuritë e fituara për mbiemrin i tregojnë duke plotësuar skemën e Kllasterit.



Veprimtaria e dytë - Gushëkuqi rrethor

Nxënësit të ndarë në katër grupe kryejnë detyrat e dhëna nga mësuesi.

Gr.I Shkruajnë mbiemra në gjininë mashkullore.

Gr.II Shkruajnë mbiemra në gjininë femërore.

Gr.III Shkruajnë emra në numrin njëjës.

Gr.IV Shkruajnë emra në numrin shumës.

Fleta paloset në formë fizarmonike dhe kalohet nga njëri nxënës tek tjetri. Nxënësit prezantojnë punën e bërë në grupe. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Numri i mbiemrit”**.

Veprimtaria e tretë - Punë e drejtuar

Mësues-i/ja paraqet me projektor foto të shoqëruara me grupe emërore:




djalë **i vogël**



vajzë **e vogël**



djem **të vegjël**



vajza **të vogla**

U drejton nxënësve pyetjet:

- Çfarë janë fjalët me ngjyrë të zezë? Po fjalët me ngjyrë të kuqe e të kaltër? Në ç’gjini janë emrat: **djalë, djem, vajzë, vajza**? Po mbiemrat: **i vogël, e vogël, të vegjël, të vogla**? Në ç’numër janë emrat: **djalë, vajzë, djem** dhe **vajza**? Si mendoni, në ç’numër do të jenë mbiemrat që u vinë pas?

Mësues-i/ja shpjegon rregullën gjuhësore

Mbiemri vendoset në atë numër që është edhe emri, tiparin e të cilit tregon.
Mbiemri, ashtu si emri ka **numrin njëjës** dhe **numrin shumës**.

Veprimtaria e katërt – Punë në tekstin mësimor/Punë e drejtuar

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe analizojnë shembujt e dhënë në tekstin mësimor. Punohet rubrika **Pyetje**.

Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale punojnë sipas këtij modeli.

Shembull:

flokë të verdhë djem besnikë

Ushtrimi 2. Nxënësit në çifte plotësojnë tabelën.

Veprimtaria e pestë – Loja “Lëviz, ndalo, krijo dyshe”

Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe kur mësuesi përplas duart, ata ndalojnë dhe formojnë çifte me shokun që kanë pranë.

Nx. 1- thotë një mbiemër në gj. mashkullore Nx. 2- thotë mbiemrin përkatës në gj. femërore

i bukur

e bukur

Nx. 1- thotë një emër në numrin njëjës Nx. 2- thotë emrin përkatës në numrin shumës

e gjatë

të gjata

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e gjashtë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe punojnë ushtrimet 2, 3 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2 punohet nga nxënësit në grupe. Mbas përfundimit të punës grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë nga nxënësit në grupe.

Ushtrimi 3.Në mënyrë individuale nxënësit përjashtojnë me X mbiemrin e vendosur gabim.

Shembull: shira i rrëmbyer X lule të verdhë X

Ushtrimi 4. Në çifte nxënësit punojnë sipas modelit .

Shembull: (një) lis i lartë - (disa) lisa të lartë


Veprimtaria e shtatë - Diagrami i Venit

Nxënësit në çifte krahasojnë nga dy mbiemra.

Shembull:


i mirë

flokëverdhë



e thellë

të cekët



Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Unë jam Andi

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë përemrat vetorë.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimin: Vëzhgo - krijo - komento, loja "Lëviz, ndalo, krijo dyshe", puno-gjej gabimet, kubimi, punë e drejtuar etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë përemrat vetorë;
- gjejnë dhe krijojnë fjali me përemra vetorë;
- mësojnë dhe argëtohen përmes teknikës kubimi dhe lojës "Lëviz, ndalo, krijo dyshe";
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: përemër vetor


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurtesë, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, fletë A4, kube etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë: Vëzhgo - krijo - komento

Ora e mësimin fillon me këtë veprimtari: Nxënësit vështrojnë me kujdes ilustrimin e paraqitur në projektor/tv nga mësues-i/ja dhe formojnë nga një fjali për çdo figurë. Çdo figurë komentohet një nga një së bashku me nxënës për të sqaruar në mënyrë intuitive dhe konkrete fjalët që tregojnë përemrat vetorë.



Shembull: Unë dje bleva një çante të re.

Mësues-i/ja: Çfarë tregon Albani me këtë fjali? (Albani-emri i nxënësit që ka krijuar fjalinë me fjalën **Unë**)

Nxënës-i/ja: Me këtë fjali Albani tregon se dje ka blerë një çantë të re.

Mësues-i/ja: Kujt ia drejton gishtin tregues Albani?

Nxënës-i/ja: Gishtin tregues Albani ia drejton vetes.

Mësues-i/ja: Fjala **Unë** a tregon një person apo shumë persona? A i përket numrit njëjës apo shumës?

Nxënës-i/ja: Fjala **Unë** tregon një person. I përket numrit njëjës.

Shembull: Ti more pesë në test.

Mësues-i/ja: Çfarë tregon Ana me këtë fjali? (Ana-emri i nxënëses që ka krijuar fjalinë me fjalën **Ti**)

Nxënës-i/ja: Me këtë fjali Ana tregon se shoku që ka pranë ka marrë notën pesë në test.

Mësues-i/ja: Kujt ia drejtojmë gishtin tregues kur përdorim fjalë **Ti**?

Nxënës-i/ja: Gishtin ia drejtojmë shokut ose shoqes që kemi pranë vetes.

Mësues-i/ja: Fjala **Ti** a tregon një person apo shumë persona? A i përket numrit njëjës apo shumës?

Nxënës-i/ja: Fjala **Ti** tregon një person. I përket numrit njëjës.

Ndiqet e njëjta veprimtari për fjalët: ai, ajo, ne, ju, ata, ato.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Përemri vetor”**.

Veprimtaria e dytë - Punë e drejtuar/Punë në tekstin mësimor

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe komentojnë tekstin “Unë jam Andi”. Më pas nxënësit lexojnë tekstin dhe krahasojnë shembujt me rregullën gjuhësore për përemrin vetor.

Fjalët: **unë , ti, ai, ajo, ne, ju, ata , ato** janë **përemra vetorë**. Përemri vetor tregon personin për të cilin po flasim. Përemrat vetorë zëvendësojnë emrat e njerëzve, kafshëve, sendeve ose vendeve.

Veta	Njëjës	Shumës
Veta I	unë	ne
Veta II	ti	ju
Veta III	ai, ajo	ata, ato

Veprimtaria e tretë - Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale krijojnë nga një fjali me përemrat e dhënë.

Shembull:

Unë po mësoj një përrallë.

Ti shkove me motrën në kinema.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit lidhin me shigjetë fjalinë me përemrin e duhur.

Shembull:

Ai do të marrë pjesë në një konkurs. Ju po mësoni gjuhën shqipe.

Ushtrimi 3. Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë vendet bosh me përemrat vectorë që duhen (Unë, ti, Unë, ti, Unë, Ne)
Kontrollohet dhe vlerësohet puna e nxënësve.

Veprimtaria e katërt: Punë në grupe/Puno-gjej gabimet.

Nxënësit të ndarë në 4 grupe gjejnë gabimet në fjalitë e dhëna me fisha nga mësues-i/ja.

Shembull fjalish për grupin e parë:

Shoferi nuk frenoi dot. **Ju** ishte me shpejtësi të madhe.

Dhelprat dinake u larguan me shpejtësi. **Ne** u frigua nga zërat e qenve.

Shembull fjalish për grupin e dytë:

Fëmijët u gëzuan kur panë luanët e cirkut. **Unë** filluan të duatrokisnin me të madhe.

Një djalë filloi t'u mburrej shokëve të lagjes. **Ne** jam më i shpejti se kam atlete të mira.

Shembuj të ngjajshëm u jepen edhe 2 grupeve të tjera. Mësues-i/ja tregon kujdes, që të përfshijë të gjithë përemrat vectorë. Mbas përfundimit të punës grupet prezantojnë punën e tyre. Nëse ka gabime, grupet korrigjojnë njëri - tjetrin. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e pestë - Loja "Lëviz, ndalo, krijo dyshe"

Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe kur mësues-i/ja përplas duart, ata ndalojnë dhe formojnë çifte me shokun që kanë pranë.

Nxënësi 1- thotë një fjali.

Nxënësi 2- thotë fjalinë duke zëvendësuar emrin me përemrin e duhur vector.

Paula mëson mirë.

Ajo mëson mirë.

Veprimtaria e gjashtë – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe punojnë ushtrimet 1, 3, 4 dhe 6 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë fjalitë me përemrat vectorë.

Shembull:

Ne do të ndërtojmë një kështjellë në breg të detit.

Ata kanë shkruar një poezi.

Ushtrimi 3. Nxënësit në çifte nënvizojnë përemrat vectorë në tekstin e dhënë. Në fund çiftet prezantojnë punën e tyre. Shpallet fitues çifti që ka punuar më shpejt dhe më saktë.

Ushtrimi 4. Nxënësit në mënyrë individuale zëvendësojnë emrat me të zezë me një përemër vector. Më pas e rishkruajnë fjalinë.

Shembull: Qielli kishte plot re. **Ai** kishte plot re.

Ushtrimi 6. Nxënësit në grupe përshkruajnë një ngjarje personale duke përdorur sa më shumë përemra vectorë. Në fund grupet prezantojnë punën e tyre. Shpallet fitues grupi që ka shkruar pa gabime dhe ka përdorur shumë përemrat vectorë.

Veprimtaria e shtatë – Kubimi

Nxënësit vendosen në tri kolona dhe fitojnë nga një kub, në faqet e të cilit janë shkruar fjalët:

unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato. Detyra e nxënësve është që të hedhin kubin dhe të thonë një fjali me përemrin vetor, që shkruan në faqen e kubit. Nxënësit që gabojnë ulen në banka dhe mendojnë të rregullojnë gabimin. Shpallet fitues grupi i nxënësve, që ka formuar më shumë fjali dhe nuk ka bërë gabime.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 2 dhe 5 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Folja

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të sqarojë se fjalët që shprehin veprim quhen folje.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimin: përvijim i të menduarit, punë e drejtuar, rrjeta e merimangës, alfabeti i njëpasnjëshëm, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, matematikë, kulturë muzikore

Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë foljen si fjalë që tregon veprim ose gjendje;
- identifikojnë foljen në fjali dhe tekst;
- krijojnë fjali të ndryshme me folje;
- mësojnë dhe argëtohen përmes teknikës rrjeta e merimangës dhe alfabeti i njëpasnjëshëm;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: fjalë që tregojnë veprime, folja


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shumës, kompjuter, projektor/tv, cd, mjete vizatimi, grafiku i alfabetit të njëpasnjëshëm etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës njohturisë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë: Përvijim i të menduarit

Ora e mësimin fillon me këtë veprimtari: Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe mësuesi plotëson skemën.



Nxënësit krijojnë fjali të ndryshme duke përdorur fjalët (veprimet) e mësipërme dhe përem-

ra të ndryshëm vetorë.

Shembull:

Në mëngjes unë **zgjohem** në orën 8.

Ai **shkruan** bukur.

Ne **mësojmë** së bashku.

Ato **lajnë** rrobat e pista.

Mbi bazën e analizës së shembujve lart, nxënësit së bashku me mësues-in/en arrijnë në këtë përfundim:

Fjalët me ngjyrë të zezë që tregojnë veprime janë folje.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin “**Folja**”.

Veprimtaria e dytë – Punë e drejtuar / Punë në tekstin mësimor

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe komentojnë tekstin “Unë i dua kafshët”. Vëzhgojnë me kujdes fjalët e nënvizuara dhe tregojnë se çfarë janë ato. Lexohet rregulla gjuhësore për foljen.

Folja tregon një veprim ose gjendje të njerëzve, të kafshëve apo të sendeve.

Veprimtaria e tretë - Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale krijojnë katër fjali, dy me folje që tregojnë veprime dhe dy me folje që tregojnë gjendje.

Shembull:

Teuta luan me Agimin. Unë jam në shtëpi.

Ushtrimi 2. Në çifte nxënësit shënojnë disa veprime që i bëjnë në situatat e dhëna dhe ato i shkruajnë në tabelë.

Shembull:

Në shkollë	Në parkun e lodrave	Në det
Unë kryej detyrat.	Unë luaj me shokë.	Unë notoj me vëllain.

Ushtrimet 3 dhe 4 punohen nga nxënësit në mënyrë individuale. Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën.

Veprimtaria e katërt: Rrjeta e merimangës

Vendosen nxënësit në rreth. Një nxënës mban lëmshin e perit në dorë. Mendon një folje dhe ia hedh lëmshin shokut, që dëshiron të përgjigjet (krijon fjali). Kështu veprohet me të gjithë nxënësit.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e gjashtë – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në grupe punojnë ushtrimet 1, 2, 3 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale përkruajnë në fjali veprimin që bën secili qenush.

Shembull: Qeni i bardhë luan me top. Qeni me topa luan me macen.

Ushtrimi 2. Nxënësit në mënyrë individuale ngjyrosin fjalën që tregon veprimin. Bashkojnë pjesët dhe krijojnë fjali. Shkruajnë fjalitë.

Shembull: Qeni **ndjek** macen. Qeni po **shëtit**.

Ushtrimet 3 dhe 5 punohen nga nxënësit në grupe. Mbas përfundimit të punës grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Veprimtaria e shtatë – Alfabeti i njëpasnjëshëm

Nxënësit të ndarë në 4 grupe fitojnë grafikun me alfabetin e njëpasnjëshëm. Detyra e grupeve është që për çdo shkronjë të alfabetit të shkruajnë një folje.

Gr.1	A	B	C	Ç	D	Dh	E	Ë	F
	afroj	bërtas	caktoj	çliroj	dëmtoj	dhuroj	edukoj	ëndërroj	fal
Gr.2	G	Gj	H	I	J	K	L	LI	M
	godas	gjej	ha	imitoj	jetoj	këndoj	lyej	llogaris	mallkoj
Gr.3	N	Nj	O	P	Q	R	Rr	S	Sh
	numëroj	njehsoj	operoj	prezantoj	qortoj	ruaj	rrethoj	stërvitem	shuaj
Gr.4	T	Th	U	V	X	Xh	Y	Z	Zh
	tund	theri	uroj	vallëzoj	xixëlloj	xhiroj	yndyrëzoj	zbardhoj	zhveshem

Në fund secili grup prezanton punën para klasës sipas shkronjave që ka pasur.

Mësues-i/ja i shkruan në grafikun e zmadhuar të vendosur para klasës. Vlerësohet puna e nxënësve.

Shpallet fitues grupi i nxënësve, që ka plotësuar më shpejt dhe saktë.

Veprimtaria e tetë - Punë në çifte

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje këngën “Mos e dëmto natyrën” dhe shkruajnë në një fletë foljet që kanë mbajtur mend. Shpallet fitues grupi që ka shkruar më shumë dhe saktë folje.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Jam (sot)-kam qenë (dje)-do të jem (nesër)

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë kohën e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti: *dje, sot, nesër*.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimimit: Përvijim i të menduarit, parashikim me terma paraprak, punë e drejtuar, kubimi, lojë, shkrim i lirë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Veprimtaritë e nxënësve:

- dallojnë tri kohët e foljes;
- nënvizojnë foljet në fjali dhe tekste dhe i klasifikojnë ato sipas kohës;
- krijojnë fjali e tekste të ndryshme me folje në kohë të ndryshme;
- mësojnë dhe argëtohen përmes teknikës kubimi;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: folja, dje, sot, nesër, kohët e foljes: e shkuar, e tashme, e ardhme


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, kompjuter, projektor/tv, mjete vizatimi, kuba etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë: Përvijim i të menduarit


Ora e mësimimit fillon me këtë veprimtari: Nxënësit njohuritë për foljen i tregojnë duke plotësuar skemën.



Veprimtaria e dytë - Parashikim me terma paraprakë

Nxënësit vështrojnë me kujdes figurat e paraqitura në projektor/tv dhe së bashku me më-

sues-in/en komentojnë çdo figurë për të kuptuar në mënyrë intuitive dhe konkrete fjalët që ndihmojnë për të përcaktuar kohën e foljes (dje, sot, nesër).



Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin “Kohët e foljes”.

Veprimtaria e tretë – Punë e drejtuar

Nxënësit krijojnë tri fjali duke përdorur fjalët: **dje, sot, nesër** dhe foljet e mësipërme. Folja veçohet me ngjyrë të kuqe


Dje unë **mësova** një tregim interesant.
 Sot Albani po **luan** në palestër.
 Nesër ne **do të vizatojmë** një pamje pranvere.

Pyetjet:

Kur është kryer veprimi? – Dje.
 Kur po kryhet veprimi? – Sot.
 Kur do të kryhet veprimi? – Nesër.

– Çfarë na ndihmojnë fjalët: **dje, sot, nesër**? Për të përcaktuar kohën e kryerjes së një veprimi.

Mbi bazën e analizës së shembujve të mësipërm, mësuesi shpjegon rregullin gjuhësor:



Veprimtaria e katërt - Lojë/garë

Tre nxënës ngrihen para tabelës dhe mbajnë në duar tre kartona me ngjyra të ndryshme me fjalët: **dje, sot, nesër**.

Nxënësit të ndarë në grupe formojnë fjali të ndryshme brenda 5 minutash. Në fund grupet lexojnë fjalitë e krijuara. Shpallet fitues grupi që ka krijuar më shumë dhe saktë fjali, ku folja është përdorur në tri kohë.

Veprimtaria e pestë - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe komentojnë tekstin “ANDJA DJE – SOT –NESËR”. Më pas lexojnë e komentojnë shembujt dhe figurat e dhëna në tekstin mësimor.

Veprimtaria e gjashtë - Punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe grupe punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërke-

save nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale përcaktojnë se cili prej pohimeve është i saktë ose i gabuar.

Shembull:

Folja isha tregon se si jam tani. **G** Folja isha tregon se si kam qenë më parë. **S**

Ushtrimi 2. Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë vendet bosh me foljet e duhura dhe vizatojnë figurën që mungon.

Ushtrimet 3 dhe 4 nxënësit i punojnë në grupe. Në fund përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre dhe korrigjojnë njëri - tjetrin. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Veprimtaria e shtatë: Kubimi


Nxënësit vendosen në tri kolona dhe fitojnë nga një kub, në faqet e të cilit janë shkruar: **koha e tashme, koha e shkuar, koha e ardhme**. Detyra e nxënësve është që të hedhin kubin dhe të thonë një fjali në kohën, që shkruan në faqen e kubit. Nxënësit që gabojnë, ulen në banka dhe mendojnë të rregullojnë gabimin. Shpallet fitues grupi i nxënësve, që ka formuar më shumë fjali dhe nuk ka bërë gabime.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e tetë - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë ushtrimet 3, 4 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 3. Nxënësit në çifte zbulojnë foljet: jam, isha, lexoj, ndihmoj.



Ushtrimi 4. Nxënësit në mënyrë individuale krijojnë një tekst të shkurtër me temën “Nesër do të bëhem...” ku do të përdorin folje në kohë të ndryshme. Lexohen disa punime nga nxënësit. Vlerësohet puna e bërë.

Ushtrimi 5. Nxënësit pasqyrojnë përmes vizatimit dëshirën e tyre.

Veprimtaria e nëntë - Punë në çifte

Çdo çift punon një tekst të shkurtër. Detyra e nxënësve në çifte është të gjejnë foljet në tekstin e dhënë dhe t’i klasifikojnë ato sipas kohëve (e shkuar, e tashme, e ardhme). Plotësojnë tabelën.

Vlerësohet puna e bërë nga nxënësit në çifte.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e marra gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 1 dhe 2 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Foljet ndryshojnë

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të kuptojë se folja ndryshon sipas vetave.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: Harta e koncepteve, lojë, punë e drejtuar, kubimi, etj.

Format e punës: Punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë.

Veprimtaritë e nxënësve:

- zgjedhjnë foljet **kam** dhe **jam** në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme në mënyrë intuitive;
- përshtasin foljet **kam** dhe **jam** sipas vetës e numrit në fjalitë e dhëna, në kohën e shkuar, tashme dhe të ardhme;
- krijojnë fjali me foljet **kam** dhe **jam** në tri kohë;
- mësojnë dhe argëtohen përmes teknikës kubimi;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Fjalët kyçe: kam, jam , koha e shkuar, e tashme ,e ardhme


Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurtes, mjete vizatimi, kuba, kartona të vegjël, fletë A4 etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë: Harta e koncepteve

Ora e mësimit fillon me këtë veprimtari: Nxënësit plotësojnë hartën e koncepteve.



Veprimtaria e dytë – Lojë me foljet **kam** dhe **jam**.

Dy nxënës para tabelës mbajnë në duar kartonat me fjalët **KAM** dhe **JAM**.

Ata u kërkojnë shokëve të thonë disa fjali duke përdorur foljet **kam** e **jam** dhe përemrat vetorë.

Fjalitë shkruhen në tabelë nga nxënësit. Folja veçohet me ngjyrë.

Shembull:

Unë **kam** kompjuter të ri.

Ti **ke** çantë të bukur.

Ai **ka** shokë të mirë.

Ne **kemi** shkollë të bukur.

Ju **keni** mësues të aftë.

Ata **kanë** prindër të kujdesshëm.

Shembull:

Unë **jam** Vjollca.

Ti **je** Ariani.

Ajo **është** Suzana.

Ne **jemi** shokë.

Ju **jeni** në klasën e tretë.

Ato **janë** vajza të sjellshme.

- Lexohen fjalitë e shkruara në tabelë dhe vëmendje e nxënësve tërhiqet te ndryshimi që ka pësuar folja.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Foljet ndryshojnë”**.

Veprimtaria e tretë – Di - dua të di – mësova

Nxënësit të nxitur nga pyetjet e mësues-it/es plotësojnë dy shtyllat e tabelës: DI - DUA TË DI. Shtylla MËSOVA plotësohet në fund të orës nga nxënësit.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Se folja tregon një veprim ose gjendje të njerëzve, të kafshëve apo të sendeve.	Si ndryshon folja?	

Veprimtaria e katërt - Punë në tekstin mësimor / Punë e drejtuar

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe komentojnë shembujt e dhënë në krye të faqes në tekstin mësimor.

Lexohet disa herë nga nxënësit zgjedhimi i foljeve **kam** dhe **jam** sipas kohës dhe vetës.

Lexohet rregulla gjuhësore:

Foljet ndryshojnë sipas **kohës** dhe sipas **vetës**.

Veprimtaria e pestë: Punim i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale lidhin me shigjetë përemrin vetor me foljen në vetën e duhur.

Shembull:

Unë kam një libër të ri.

Ti ke një libër të ri.

Ai ka një libër të ri.

Ushtrimi 2. Nxënësit në mënyrë individuale qarkojnë formën e saktë të foljes.

Shembull: Ana dhe Paulini ndërtuan një kala prej rëre.

Dita është e mrekullueshme.

Ushtrimet 3 dhe 4 nxënësit i punojnë në çifte. Vlerësohet puna e bërë nga nxënësit në çifte.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e gjashtë – Punë në fletore pune


Nxënësit në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 2, 3, 4 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Nxënësit në çifte krijojnë gjashtë fjali me foljen KAM duke e përdorur në kohë të ndryshme.

Shembull:

Ai ka një vëlla. Dje Teuta kishte garat e recitimit.

Ushtrimi 3. Nxënësit në grupe zbulojnë rrugën që ka ndjekur folja KAM. Në fund grupet ia japin librin njëri-tjetrit për ta korigjuar. Shpallet fitues grupi që ka kryer detyrën saktë dhe shpejt.



Ushtrimet 4 dhe 5 nxënësit i punojnë të pavarur. Kontrollohet dhe vlerësohet puna e nxënësve.

Veprimtaria e shtatë: Kubimi

Nxënësit të ndarë në 6 grupe fitojnë nga një kub, në faqet e të cilit janë shkruar foljet: **jam, isha, do të jem, kam, kisha, do të kem**. Detyra e nxënësve është që të hedhin kubin dhe të krijojnë 6 fjali me foljen në kohën, që shkruan në faqen e kubit. Në fund përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre. Nëse ka gabime grupet korrigjojnë njëri-tjetrin nën përcjelljen e mësues-it/es.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e marra gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

KAPUTULLI I TRETË

LEXOJMË DHE KRIJOJMË TEKSTE

PLANIFIKIME DITORE

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Mësojmë të ftojmë

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lexojë me zë ose në heshtje dhe pastaj të shkruajë vetë tekste të thjeshta joletrare: ftesa, kartolina, urime, përshkrime personash.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimin: bisedë, punë e drejtuar, truri i galerisë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- shkruajnë ftesa të ndryshme;
- lexojnë dhe komentojnë ftesat e dhëna në tekstin mësimor;
- gjejnë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit;
- punojnë në mënyrë individuale dhe në çifte ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës.

.....
Fjalët kyçe: ftesa, urimi.

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurmes, mjete vizatimi, fletë A4 etj.

.....
ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë: Bisedë

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë, komentojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën “Shumë urime për ty”. Për të nxitur bisedën, mësuesi mund t’u drejtojë këto pyetje: Si e festoni ju ditëlindjen? Me kë e festoni? Kë ftoni për ditëlindje? Si i ftoni? A shkruani ftesa? Si bëhen ftesat? A keni shkruar ju ftesa? A keni marrë ju ose anëtarët e familjes suaj ndonjë ftesë? etj.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimin dhe shkruan në tabelë titullin “ **Mësojmë të ftojmë**”.

Veprimtaria e dytë: Punë e drejtuar

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes dy ftesat e paraqitura në videoprojektor dhe i komentojnë

ato me mësues-in/en. Mbi bazën e komentimit të ftesave mësues-i/ja shpjegon:

Ftesa është një letër e shtypur a e shkruar që i dërgohet dikujt për të marrë pjesë në një festë, në një pritje ose në një ceremoni me rastin e ndonjë dite të shënuar. Për të dërguar një ftesë duhet të ndjekim 7 hapa.

Veprimtaria e tretë – Punë në tekstin mësimor / Punë e drejtuar

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe komentojnë ftesat e dhëna në tekstin mësimor.

Punim i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë përkufizimet për marrësin dhe dërguesin.

Ushtrimi 2. Nxënësit në mënyrë individuale shënojnë me \surd përgjigjen e saktë (b).

Ushtrimet 3. Nxënësit në mënyrë individuale shënojnë tri ngjarje ku do të kishin dashur që të ishin të ftuar.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e katërt - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë ushtrimet 2, 3, 4 dhe 5 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Nxënësit në çifte lexojnë me kujdes ftesën dhe plotësojnë elementet që i mungojnë.

Ushtrimi 3. Nxënësit në mënyrë individuale shkruajnë një letër a shënim për të kërkuar falje.

Ushtrimi 4. Nxënësit në mënyrë individuale i shkruajnë një ftesë të thjeshtë shokut/shoqes për të luajtur.

Ushtrimi 5. Nxënësit në mënyrë individuale krijojnë një ftesë për një ngjarje të rëndësishme për ta.

Veprimtaria e pestë: Punë në grupe / Turi i galerisë

Nxënësit të ndarë në grupe punojnë detyrat që u jep mësues-i/ja:

Gr.1 – Shkruajnë një ftesë për ditëlindje.

Gr.2 – Shkruajnë një ftesë për Vitin e Ri.

Gr.3 – Shkruajnë një ftesë për Ditën e shkollës.

Gr.4 – Shkruajnë një ftesë për dasëm.

Në fund grupet prezantojnë punën e tyre dhe ftesat i vendosin në këndin e klasës. Vlerësohen nxënësit për punën e bërë në grupe.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e marra gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Cikli i ujit

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lexojë me zë dhe në heshtje tekstet joletrare shkencore;
- të dallojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të shtrojë pyetje dhe të përgjigjet në pyetje mbi tekstin.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimin: bisedë, punë e drejtuar, leximi drejtuar, lexim zinxhir, shkrim i lirë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën;
- lexojnë tekste joletrare, u përgjigjen pyetjeve mbi të dhënat kryesore të tekstit të lexuar;
- artikulojnë përvojat e veta për temën e njëjtë;
- krijojnë me shkrim tekste të ngjashme;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit;
- punojnë në mënyrë individuale dhe në çifte ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës.

.....
Fjalët kyçe: tekste joletrare shkencore, cikli i ujit

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, mjete vizatimi, kompjuter, projektor/tv, cd, fletë A4, enciklopedi etj.


.....
ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I - Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë – Brainstorming/ Këndim

Ora e mësimin fillon me këtë veprimtari: Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë "Shiu dhe ylberi".

Më pas bisedojnë me njëri-tjetrin për rëndësinë e ujit dhe japin mendimet e tyre për plotësimin e skemës.



Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e dytë – Punë në tekstin mësimor / Punë e drejtuar

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimin dhe shkruan në tabelë titullin **“Cikli i ujit”**.

Nxënësit lexojnë me kujdes tekstin “Cikli i ujit” dhe përgjigjen në rubrikën **Pyetje**.

Veprimtaria e tretë - Punim i ushtrimeve në tekstin mësimor

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në grupe punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale poshtë ilustrimeve vendosin nga një numër sipas rendit që duhet (1, 4, 2, 3).

Ushtrimi 2. Nxënësit në mënyrë individuale shënojnë ku mund ta shfrytëzojnë ujin në jetën e tyre.

Shembull: Për të ujitur bimët.

Për të mirëmbajtur higjienën.

Ushtrimet 3. Nxënësit në grupe diskutojnë rreth teksteve të sjella në klasë për ujin.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e katërt – Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale gjejnë fjalët që lidhen me emrin “ujë”:

akuariumi bojëra uji gotë uji shishe uji

Ushtrimi 2. Nxënësit në çifte krijojnë fjali me fjalët e shprehjet: akuarium, bojëra uji, gotë uji, shishe uji.

Shembull: Unë kam në shtëpi një akuarium me peshq.

Almedina bëri një pikturë me bojëra uji.

Ushtrimi 3. Nxënësit në mënyrë individuale krijojnë një tekst me temën “Uji në jetën time”.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e marra gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimin _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Liqeni i Shasit

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lexojë me zë dhe në heshtje tekstet joletrare shkencore;
- të dallojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të bisedojë me shokët e klasës për përmbajtjen e tekstit të lexuar, në mënyrë që ta kuptojë më mirë;
- të shtrojë pyetje dhe të përgjigjet në pyetje mbi tekstin.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: bisedë, punë e drejtuar, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, shkrim i lirë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- përcjellin me vëmendje videon dhe bisedojnë për përmbajtjen e saj;
- lexojnë tekste joletrare, u përgjigjen pyetjeve mbi të dhënat kryesore të tekstit të lexuar;
- artikulojnë përvojat e veta për temën e njëjtë;
- krijojnë me shkrim tekste të ngjashme;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit;
- punojnë në mënyrë individuale dhe në çifte ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës.

.....
Fjalët kyçe: tekste joletrare shkencore, liqeni i Shasit

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, mjete vizatimi, kompjuter, projektor/tv, cd, fletë A4, enciklopedi etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë – Bisedë

Ora e mësimit fillon me këtë veprimtari: Nxënësit përcjellin me kujdes një video për liqenin e Shasit dhe më pas bisedojnë me mësues-in/en. Për të nxitur bisedën mësuesi u drejton këto pyetje: A dini për cilin liqen bëhet fjalë? A keni qenë ndonjëherë në këtë liqen? Ku ndodhet? Çfarë ka të veçantë? A dini ndonjë histori rreth këtij liqeni? A dini si është ndërtuar? etj.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e dytë – Punë në tekstin mësimor / Punë e drejtuar.

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimin dhe shkruan në tabelë titullin “ **Liqeni i Shasit** ”.

Nxënësit lexojnë me kujdes tekstin “Liqeni i Shasit” dhe përgjigjen në rubrikën **Pyetje**.

Veprimtaria e tretë - Punim i ushtrimeve në tekstin mësimor

Nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale shënojnë tri tipare të liqenit të Shasit.

Shembull: Liqeni i Shasit është me origjinë tektonike.
Përmasat e liqenit pësojnë luhate të mëdha stinore.
Liqeni i Shasit është stacion ornitologjik.

Ushtrimi 2. Nxënësit në mënyrë individuale shënojnë emrat e disa peshqve që jetojnë në liqenin e Shasit.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Hapi III - Përforsim

Veprimtaria e katërt – Punë në fletore pune

Nxënësit në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 2, 3 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 2. Nxënësit në çifte lexojnë dy tekstet e gjetura për ujën.

Ushtrimi 3. Nxënësit në grupe diskutojnë dallimet mes këtyre teksteve.

Ushtrimi 4. Nxënësit në grupe diskutojnë për të dhënat e mbledhura në enciklopedi dhe internet për liqenin e Plavës. Vlerësohet puna e nxënësve.

Veprimtaria e pestë - Punë në grupe

Nxënësit të ndarë në grupe me teknika të ndryshme të vizatimit paraqesin pamje të liqenit të Shasit. Punimet në fund i pasqyrojnë në këndin e vizatimit.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e marra gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimin _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Vëzhguesit e qiellit

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lexojë me zë dhe në heshtje tekstet joletrare shkencore;
- të dallojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të bisedojë me shokët e klasës për përmbajtjen e tekstit të lexuar, në mënyrë që ta kuptojë më mirë;
- të shtrojë pyetje dhe të përgjigjet në pyetje mbi tekstin.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mëimit: Brainstorming, punë e drejtuar, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, shkrim i lirë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore, matematikë.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën;
- përcjellin me vëmendje videon dhe bisedojnë për përmbajtjen e saj;
- lexojnë tekste joletrare, u përgjigjen pyetjeve mbi të dhënat kryesore të tekstit të lexuar;
- artikulojnë përvojat e veta për temën e njëjtë;
- krijojnë me shkrim tekste të ngjashme;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës.

.....
Fjalët kyçe: tekst joletrare shkencor, vëzhguesit e qiellit, teleskopi, universi, planetet

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkurtesë, mjete vizatimi, kompjuter, projektor/tv, cd, fletë A4, enciklopedi etj.

ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë – Brainstorming/ Këndim

Ora e mëimit fillon me këtë veprimtari: Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë “Kënga e planetëve”.

Më pas bisedojnë me njëri-tjetrin për teleskopin dhe japin mendimet e tyre për plotësimin e skemës.



Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e dytë - Punë në tekstin mësimor / Punë e drejtuar

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Vëzhguesit e qiellit”**.

Nxënësit lexojnë me kujdes tekstin **“Vëzhguesit e qiellit”** dhe përgjigjen në rubrikën **Pyetje**.

Veprimtaria e tretë - Punim i ushtrimeve në tekstin mësimor.

Nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale krijojnë fjali me fjalët: univers, teleskop, planet.

Shembull:
Universi është shumë i madh.
Albertit i pëlqen të shikojë me teleskop.
Ne jetojmë në planetin Tokë.

Ushtrimi 2. Nxënësit në mënyrë individuale përmbledhin shkurtimisht në fletore paragrafin e dytë të pjesës **“Vëzhguesit e qiellit”**.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e katërt - Punë në fletore pune

Nxënësit në çifte dhe grupe punojnë ushtrimet 3 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 3. Nxënësit në çifte diskutojnë fakte për vëzhguesit e qiellit.

Ushtrimi 4. Nxënësit në grupe krijojnë një tekst për universin, pasi që në projektor vëzhgojnë një video për universin. Grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e marra gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 1 dhe 2 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimit _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Vallet tona

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të bisedojë me shokët e klasës për përmbajtjen e tekstit të lexuar, në mënyrë që ta kuptojë më mirë;
- të shtrojë pyetje dhe të përgjigjet në pyetje mbi tekstin.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimit: diskutim, punë e drejtuar, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, shkrim i lirë etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- përcjellin me vëmendje videon dhe bidojnë për përmbajtjen e saj;
- lexojnë tekste joletrare, u përgjigjen pyetjeve mbi të dhënat kryesore të tekstit të lexuar;
- artikulojnë përvojat e veta për temën e njëjtë;
- krijojnë me shkrim tekste të ngjashme;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës.

.....
Fjalët kyçe: tekst joletrar, valle popullore

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, mjete vizatimi, kompjuter, projektor/tv, fletë A4 etj.

.....
ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë – Diskutim

Ora e mësimit fillon me këtë veprimtari: Nxënësit shikojnë në projektor një video për vallet popullore shqiptare. Më pas diskutojnë me mësues-in/en për videon e shikuar. Shprehin përvojat e tyre për vallet popullore shqiptare.

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e dytë – Punë në tekstin mësimor / Punë e drejtuar

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë titullin **“Vallet tona”**.

Nxënësit lexojnë me vëmendje dhe komentojnë së bashku me mësues-in/en tekstin “Vallet tona”. Më pas përgjigjen në rubrikën **Pyetje**.

Veprimtaria e tretë - Punim i ushtrimeve në tekstin mësimor

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në çifte punojnë me rubrikën e ushtrimeve, sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale shkruajnë dy fakte për vallet popullore.

- Shembull:**
- Vallet popullore janë pjesë e kulturës artistike popullore dhe përfshijnë dy gjini kryesore: lirike dhe epike.
 - Vallet popullore na lidhin me të kaluarën dhe na kujtojnë rëndësinë e ruajtjes së traditës për brezat e ardhshëm.

Ushtrimi 2. Nxënësit në çifte përmendin emrat e disa valleve popullore.

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e katërt - Punë në fletore pune.

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në grupe punojnë ushtrimet 3 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 3. Nxënësit në grupe diskutojnë për vallet karakteristike të fshatit, bajrakut dhe qytetit të tyre. Komentojnë fotot e sjella në klasë duke sjellë edhe informacion për veshjet që i shoqërojnë këto valle.

Ushtrimi 4. Nxënësit në mënyrë individuale ngjisin foto të valleve të ndryshme popullore.

Ushtrimi 5. Nxënësit në mënyrë individuale krijojnë një tekst me temë “Vallet tona”. Lexohen disa punime. Vlerësohen nxënësit për punën e bërë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e marra gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 1 dhe 2 në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Përfundime për orën e mësimi _____

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Tema mësimore: Njeriu dhe teknologjia

Arritjet e të nxënimit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

të lexojë me zë dhe në heshtje tekstet joletrare shkencore;

të dallojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;

të bisedojë me shokët e klasës për përmbajtjen e tekstit të lexuar, në mënyrë që ta kuptojë më mirë;

të shtrojë pyetje dhe të përgjigjet në pyetje mbi tekstin.

Metodat dhe teknikat e realizimit të orës së mësimimit: Pyetja e ditës, punë e drejtuar, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, shkrim i lirë, demonstrim etj.

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore, art figurativ, matematikë.

.....
Veprimtaritë e nxënësve:

- dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën;
- lexojnë tekste joletrare shkencore, u përgjigjen pyetjeve mbi të dhënat kryesore të tekstit të lexuar;
- artikulojnë përvojat e veta për temën e njëjtë;
- krijojnë me shkrim tekste të ngjashme;
- shprehin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimet e tyre;
- prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë punën e njëri-tjetrit;
- punojnë në mënyrë individuale, në çifte dhe grupe ushtrimet nga teksti mësimor dhe fletorja e punës.

.....
Fjalët kyçe: njeriu, teknologjia

Burimet, materialet dhe mjetet didaktike: teksti mësimor, fletore pune, tabelë, shkumës, mjete vizatimi, kompjuter, projektor/tv, cd, telefon, tablet fletë A4 etj.

.....
ECURIA E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)

Hapi I – Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Veprimtaria e parë - Këndim / Pyetja e ditës

Ora e mësimimit fillon me këtë veprimtari: Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë "Teknologjia".

Më pas bisedojnë me njëri-tjetrin për teknologjinë dhe japin mendimet e tyre për pyetjen e ditës: **Cilat janë të mirat dhe dobësitë e teknologjisë?**

Hapi II - Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria e dytë – Punë në tekstin mësimor / Punë e drejtuar

Mësues-i/ja prezanton temën e mësimin dhe shkruan në tabelë titullin “ **Njeriu dhe teknologjia**”.

Nxënësit lexojnë me vëmendje dhe komentojnë së bashku me mësuesin tekstin “**Njeriu dhe teknologjia**”. Më pas përgjigjen në rubrikën **Pyetje**.

Hapi III - Përforcim

Veprimtaria e katërt - Punë në fletore pune

Nxënësit në mënyrë individuale dhe në grupe punojnë ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 sipas kërkesave nga fletorja e punës.

Ushtrimi 1. Nxënësit në mënyrë individuale përmendin dy shpikje të teknologjisë që njohin.

Ushtrimi 2. Nxënësit në mënyrë individuale përfundojnë fjalitë me informacione nga teksti “**Njeriu dhe teknologjia**”.

Ushtrimi 3. Ftohet në klasë një prind ose gjysh i një fëmije dhe nxënësit bëjnë një intervistë me të.

Ushtrimi 4. Në grupe nxënësit krijojnë një tekst me temën “Njeriu dhe teknologjia”. Në fund grupet prezantojnë punën e tyre. Vlerësohet puna e bërë në grupe.

Veprimtaria e pestë – Demonstrim.

Demonstrim i përdorimit të teknologjisë në klasë nga nxënësit.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e marra gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Shkruajnë një tekst për një shpikje të teknologjisë që atyre u pëlqen më shumë.

Përfundime për orën e mësimin _____

	<p>DETYRA E PARË E KONTROLLIT NGA GJUHA SHQIPE</p> <p>Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: _____</p> <p>Data: _____</p>	
1	<p>Shkruani një dialog ku të përdorni disa nga shprehjet: Përshëndetje! Mirëdita! Si je? Si shkoi dita sot? Vendosuni nga një emër bashkëbiseduesve.</p>  <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	4
2	<p>Shkruani rregullat e bisedës.</p> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	4
3.	<p>Plotësoni dialogët sipas situatave.</p> <p>a.) Toma kërkon të flasë me Arditin. Ai telefonon dhe në anën tjetër të telefonit përgjigjet Arditi.</p> <p>Alo, mirëmbërëma! A mund të _____, të lutem?</p> <p>– _____! Arditi po ju flet.</p> <p>– Ardit, Toma jam. _____</p> <p>– _____</p> <p>– _____</p> <p>– _____</p> <p>b.) Toma kërkon të flasë me Arditin. Ai telefonon, por Arditi nuk është në shtëpi dhe duhet të telefonojë më vonë.</p> <p>– _____, mirëdita! A mund të _____, të lutem?</p> <p>– Më vjen keq. Ai nuk _____. A mund të telefononi më vonë?</p> <p>– Po, _____! Në cilën orë _____?</p> <p>– A mund ta merrni pas orës _____?</p> <p>– Po, _____! Mirupafshim!</p> <p>– _____!</p>	6




4	<p>Plotësoni.</p> <p>*Dialogu është _____</p> <p>_____</p> <p>*Disa rregulla të bisedës në telefon janë: përshëndetja, prezantimi, _____</p> <p>_____</p> <p>_____</p>	2
5	<p>Renditni fjalët sipas alfabetit: borë, ftohtë, mal, slita, zjarr, çaj, prindër, makinë, shall, doreza, gëzim.</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p>	2



Vlerësimi

Arritur pjesërisht 	Arritur kryesisht 	Arritur në tërësi 




Nënshkrimi i mësues-it/es

Nënshkrimi i prindit

DETYRA E DYTË E KONTROLLIT NGA GJUHA SHQIPE Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: _____ Data: _____		
1	Shënoni me <u>√</u> fjalinë dhe me <u>X</u> jo – fjalinë. Vitaminat janë të dobishme për shëndetin. _____ Biberon fle me gojë në bebja. _____ Teuta kur rrudhi pjatën buzët shikoi. _____ Ne i ujitim lulet çdo mëngjes. _____	2
2	Formoni tekst duke vendosur fjalitë sipas radhës. Shkruani numrat në vijat pranë fjalive. _____ Ajo ka sy të kaltër dhe flokë kaçurrel. _____ Motra ime quhet Marigona. _____ Në klasë është e para në mësimet dhe sjellje. _____ Ajo është në klasën e pestë.	2
3	Renditini si duhet fjalët për të krijuar fjali. a) lexon Motra libra ime shumë. _____ b) Behari Ulqin në jeton. _____ c) Nxënësit me vonesë nuk në shkollë shkojnë. _____	3
4	Krijoni një tekst të shkurtër për foton e dhënë.  _____ _____ _____ _____	5
5	Shkruani nga një fjali për secilën figurë.  _____  _____	4


6	Lexoni më poshtë. Cili prej tyre është tekst dhe cili nuk është ? Shënoni me √ përgjigjen e saktë dhe me X përgjigjen e gabuar.		4
	<p>Merita dhe Jasmina janë shoqe. Valboni vizaton bukur. Sot është ditë e bukur. Nazmija shkoi te Ibrahimimi për festë.</p>	<p>Daja i Blertës ka një album të vjetër. Aty ai ruan me kujdes shumë fotografi. Blerta i lutet dajës ta shohin bashkë albumin e tij. Daja pranon me kënaqësi.</p>	
			

Vlerësimi

Arritur pjesërisht 	Arritur kryesisht 	Arritur në tërësi 




Nënshkrimi i mësues-it/es

Nënshkrimi i prindit

DETYRA E TRETË E KONTROLLIT NGA GJUHA SHQIPE		
	Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: _____ Data: _____	
1	Shënoni me \surd ose X fjalët e ndara mirë apo gabim në fund të rreshtit. <input type="checkbox"/> kape - la <input type="checkbox"/> shkol - la <input type="checkbox"/> lum - ë <input type="checkbox"/> fla - muri <input type="checkbox"/> mac - ja <input type="checkbox"/> u - ra	3
2	Rishkruani fjalitë, duke rregulluar fjalët që janë ndarë gabim. Në klasë Teuta është e para në mësim dhe sjel-lje. _____ Kukulla me flokë të verdhë quhet Barb-i. _____	4
3.	Shkruani nëse është e saktë (S) apo e gabuar (G). a. Në fund të rreshtit mund të ndahet edhe një shkronjë e vetme. _____ b. Fjalët nuk mund të ndahen sipas rrokjeve. _____ c. Fjalët njërrrokëshe nuk ndahen në fund të rreshtit. _____ ç. Bashkëtingëlloret sh, th mund të ndahen. _____	2
4	Shkruani një kartolinë për nënën/babain tuaj. <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin: 10px 0;">  </div>	4



5	<p>Plotësoni se çfarë duhet të kemi parasysh kur shkruajmë një letër.</p> <p>a. _____</p> <p>b. _____</p> <p>c. _____</p> <p>d. _____</p>	4
6	<p>Qarkoni përgjigjen e saktë.</p> <p>a. Shënimet duhet të jenë të shkurtra.</p> <p>b. Shënimet duhet të jenë të gjata.</p> <p>a. Kartolina është një prej mënyrave me të cilën ne mund të urojmë dikë.</p> <p>b. Kartolina është një prej mënyrave me të cilën ne ankohemi te dikush.</p> <p>a. Letra është një formë komunikimi.</p> <p>b. Letra nuk është një formë komunikimi.</p>	3
7.	<p>Shkruani një urim shokut/shoqes për ditëlindje.</p> <div style="border: 2px solid orange; border-radius: 20px; height: 150px; width: 100%;"></div>	4

Vlerësimi

Arritur pjesërisht 	Arritur kryesisht 	Arritur në tërësi 




Nënshkrimi i mësues-it/es

Nënshkrimi i prindit

DETYRA E KATËRT E KONTROLLIT NGA GJUHA SHQIPE		
Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: _____ Data: _____		
1.	Nënvizoni me një vijë kryefjalën dhe me dy vija kallëzuesin. a) Fëmijët pastruan oborrin e shtëpisë. b) Teuta dhe Nazmija vizatojnë bukur.	2
2.	Plotësoni fjalitë me kryefjalën e duhur. _____ cicëron në degë. _____ noton në det. _____ shpjegon mësimin. _____ lexon vjershën.	2
3.	Plotësoni fjalitë me kallëzuesin e duhur. Macja _____. Nxënësit _____. Këngëtari _____. Kuzhinieri _____.	2
4	Pjesëve kryesore të fjalisë shtojuni pjesët plotësuese. Macja _____ po luan _____. Flamuri _____ është _____.	2
5	Shkruani nga një fjali për çdo figurë . Në fjalitë e krijuara nënvizoni me ngjyrë të kuqe pjesët kryesore dhe me ngjyrë të verdhë pjesët plotësuese.  _____  _____	4




6.	Lexoni fjalitë dhe gjeni pjesët plotësuese të kryefjalës dhe të kallëzuesit. I ndani në dy kolona.		4
	a) Motrës së Andit i pëlqen byreku i gjyshes.		
	b) Lepuri i bardhë vrapoi shpejt.		
	Nr.	Fjalët plotësuese të kryefjalës	Fjalët plotësuese të kallëzuesit
	1.		
	2.		
7.	Ktheni fjalitë e mëposhtme në gjuhën standarde.		4
	a) Çika shkoi me babën në qytet.		
	b) Nana bleu tamel në dyqan.		

Vlerësimi

Arritur pjesërisht 	Arritur kryesisht 	Arritur në tërësi 




Nënshkrimi i mësues-it/es

Nënshkrimi i prindit

DETYRA E PESTË E KONTROLLIT NGA GJUHA SHQIPE		
	Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: _____ Data: _____	
1.	Në fjalitë e mëposhtme nënvizo fjalinë e thjeshtë. Rishkruaje atë. Mira lexon një përrallë të bukur. _____ Fëmijët e fshatit këndojnë të gëzuar. _____	4
2.	Vendosni shenjën e pikësimit që duhet. Shkruani llojin e fjalisë. Kush ta bleu këtë fustan të bukur _____ Ua, sa qenke rritur _____ Në vjeshtë piqen shumë fruta _____	3
3.	Renditni si duhet fjalët për të krijuar fjali. a) Tund pemëve e era degët. _____ b) Plavës i bukur është liqeni. _____ c) Pemë në cicëron zogu. _____	3
4.	Shkruaj nga një fjali për çdo figurë. Vendos shenjat e pikësimit. <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: flex-start;"> <div style="text-align: center;"> <p>a.</p>  </div> <div style="text-align: center;"> <p>b.</p>  </div> <div style="text-align: center;"> <p>c.</p>  </div> </div> a. Pyesim _____ b. Çuditemi _____ c. Tregojmë _____	3
5.	Krijoni fjali pyetëse me grupet e fjalëve të dhëna. a) Ku shkoi _____ b) Çfarë bleu _____	2

6	<p>Ktheni fjalinë nga e thjeshtë në të zgjeruar dhe anasjelltas. Mësuesja shpjegon.</p> <hr/> <p>Lepuri vrapon shpejt.</p> <hr/>	2
7	<p>Krijoni fjali thirrmore me grupet e fjalëve të dhëna. Sa bukur</p> <hr/> <p>U bëfsh</p> <hr/>	2

Vlerësimi

Arritur pjesërisht 	Arritur kryesisht 	Arritur në tërësi 




Nënshkrimi i mësues-it/es

Nënshkrimi i prindit

DETYRA E GJASHTË E KONTROLLIT NGA GJUHA SHQIPE						
	Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: _____ Data: _____					
1	Nënvizoni me ngjyrë të kuqe emrat dhe me ngjyrë të kaltër mbiemrat. a) Djali i vogël po luan me makinë të kuqe. b) Kukulla me flokë të verdha quhet Barbi.	4				
2	Vendosni në kuti + kur emrat janë të përgjithshëm dhe – kur janë të përveçëm. <div style="display: flex; justify-content: space-around; margin-top: 10px;"> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> vajza</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> Plavë</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> Triesh</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> bankë</div> </div> <div style="display: flex; justify-content: space-around; margin-top: 10px;"> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> ftua</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> lodër</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> Podgoricë</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> shkollë</div> </div> <div style="display: flex; justify-content: space-around; margin-top: 10px;"> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> Balo</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> lopë</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> qytet</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> Petrit</div> </div>	4				
3.	Plotësoni . a) Emrat janë fjalë që _____ b) Emrat janë dy llojesh: _____ c) Mbiemri tregon _____ ç) Emri ka dy gjini: _____ d) Mbiemrat janë dy llojesh: _____	5				
4	Vendosni në vendin e duhur emrat: zogj, shoqja, lapsi, libra, lepuj, ketri, më-suesi, nxënësit, fshatra. <table border="1" style="width: 100%; margin-top: 10px;"> <thead> <tr> <th style="width: 50%; text-align: center;">Numri njëjës</th> <th style="width: 50%; text-align: center;">Numri shumës</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="height: 80px;"></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Numri njëjës	Numri shumës			3
Numri njëjës	Numri shumës					
5	Lidhni me shigjetë. <div style="display: flex; justify-content: space-between; margin-top: 10px;"> <div style="width: 45%;"> dashi delja dritarja shoku lisi çanta </div> <div style="width: 45%; text-align: center;"> gjinia mashkullore gjinia femërore </div> </div>	2				

6.	<p>Në tekstin e mëposhtëm vendosni shkronjën e madhe dhe pikën aty ku duhet.</p> <p>Ariana lexon shumë libra një ditë ajo bleu një libër me përralla libri i pëlqeu shumë librin pasi e lexoi e vendosi në raftin e bibliotekës Ariana është nxënësja më e mirë e klasës</p>	2
7.	<p>Nënvizoni me ngjyrë të kuqe mbiemrat e nyjshëm dhe me ngjyrë të kaltër mbiemrat e panyjshëm.</p> <p>i madh, zemërmirë, guximtar, frikacak, i vogël, e ëmbël</p>	2
8.	<p>1. Shkruani nëse është e saktë (S) apo e gabuar (G).</p> <p>a. Dy pikat paralajmërojnë një numërim. _____</p> <p>b. Presja ndan vetëm dy fjali. _____</p> <p>c. Pas pikës bëjmë një pushim të shkurtër. _____</p> <p>ç. Pas pikëpyetjes dhe pikëçuditjes bëjmë një pushim të gjatë. _____</p>	2

Vlerësimi

Arritur pjesërisht 	Arritur kryesisht 	Arritur në tërësi 




Nënshkrimi i mësues-it/es

Nënshkrimi i prindit

DETYRA E SHTATË E KONTROLLIT NGA GJUHA SHQIPE		
Emri dhe mbiemri: _____		Klasa: _____
		Data: _____
1.	Zëvendësoni emrat me të zezë me një përemër vetor. Rishkruajeni fjalinë. Nëna gatuan gjellë të shijshme. _____ Babai është dentist. _____ Adriani e Besniku luajnë futboll. _____ Tavolinat ishin të pastra. _____	4
2.	Nënvizoni foljet në fjalitë e mëposhtme. Mira doli nga shkolla e gëzuar. Dentisti mjekon dhëmbët. Zogjtë ishin shumëngjyrësh me bishta të gjatë si ylber. Genti do të mësojë me Aishen.	2
3.	Lidhni me shigjetë. Lart në qiell dielli shkëlqen shumë. _____ Nesër Ana do të shkojë në kinema me prindër. _____ Dje Nora ka festuar ditëlindjen. _____ Eltoni është në klasën e tretë. _____	koha e shkuar koha e tashme koha e ardhme 2
4.	Shkruani tri fjali me këto folje: vrapo, vizato, këndo në kohën e tashme . 1. _____ (thirrmore) 2. _____ (dëftore) 3. _____ (pyetëse)	3

5.	<p>Përgjigjuni me Po ose Jo.</p> <ul style="list-style-type: none"> Foljet janë fjalë që tregojnë punë, veprim ose dukuri të natyrës. Përemrat vetorë të numrit njëjës janë: ne, ju, ata/ato. Kohët e foljes janë: koha e shkuar, e tashme dhe e ardhme. Përemrat vetorë: unë dhe ti kanë gjini. 	2																												
6.	<p>Nënvizoni formën e saktë të foljes.</p> <p>a) Shoqet e mia kanë / janë besim në fitore.</p> <p>b) Në pranverë do të kemi / do të jemi garat shkollore.</p>	2																												
7.	<p>Nënvizoni foljet në fjalitë e dhëna. I analizoni ato sipas modelit.</p> <ol style="list-style-type: none"> Nesër do të kem gara. Ti je mjek i zoti. Ata ishin nxënës të sjellshëm. Vajzat kanë veshur fustane të bukura. Prindërit janë dhe do të jenë gjithçka për ne. Ne kishim mbledhur shumë pulla postare. <table border="1" data-bbox="261 1029 1339 1342"> <thead> <tr> <th>Folja</th> <th>Veta</th> <th>Numri</th> <th>Koha</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>do të kem</td> <td>I</td> <td>njëjës</td> <td>e ardhme</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Folja	Veta	Numri	Koha	do të kem	I	njëjës	e ardhme																					5
Folja	Veta	Numri	Koha																											
do të kem	I	njëjës	e ardhme																											

Vlerësimi

Arritur pjesërisht 	Arritur kryesisht 	Arritur në tërësi 

Nënshkrimi i mësues-it/es

Nënshkrimi i prindit

Literaturë

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe* (grup autorësh), Tiranë, 2002.
3. Çepani, A. "Vështirësi të fëmijëve në kalimin nga gjuha e folur në të shkruarën", *Gjuha jonë*, nr. 1-4, Tiranë, 2009, f. 178-185.
4. Clark EV. *First Language Acquisition*. Cambridge University Press, 2009.
5. Gjokutaj, M. & Dode, E., *Didaktika e gjuhës shqipe* (kurrikula I -VI), Shtëpia Botuese "Shkronjë pas Shkronje", Tiranë, 2013.
6. Council of Europe. Council for Cultural Co-operation. Education Committee. Modern Languages Division. (2001). *Common European framework of reference for languages: Learning, teaching, assessment*. Cambridge University Press.
7. Kolodziej, N. J., Smith, S. H., Roe, B. (2018). *Teaching Reading in Today's Elementary Schools*. United States: Cengage Learning.
8. Memushaj, R. *Shqipja standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2002.
9. Programi i lëndës mësimore "Gjuhë shqipe dhe Letërsi" (Për klasët I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe IX të shkollës fillore), Enti i Shkollimit në Mal të Zi, Podgoricë, 2017.
10. Shefik, Osmani, "Probleme të ciklit të ulët në rrjedhën e viteve ", Tiranë, 2015.

